

BANKA PËR BIZNES SH.A.

PASQYRAT FINANCIARE TË PËRGATITURA NË
PËRPUTHJE ME RREGULLAT DHE RREGULLORET E
BANKËS QENDRORE TË KOSOVËS

PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2017

ME RAPORTIN E AUDITORIT TË PAVARUR

Përmbajtja

Raporti i Auditorit të Pavarur

	Faqe
Pasqyrat Financiare	
Pasqyra e të Ardhurave Gjithëpërfshirëse	1
Pasqyra e Pozicionit Financiar	2
Pasqyra e Ndryshimeve në Ekuitet	3
Pasqyra e Rrjedhës së Parasë	4
Shënimet për Pasqyrat Financiare	5-58

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

Për Aksionarët e Banka për Biznes Sh.a

Raport mbi auditimin e pasqyrave financiare

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Banka për Biznes Sh.a (më poshtë "Banka"), që përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datë 31 dhjetor 2017, pasqyrën e të ardhurave gjithpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet dhe pasqyrën e rrjedhës së parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur të Bankës më 31 dhjetor 2017 janë përgatitur, në të gjithë aspektet materiale, në përputhje me Rregullat dhe Rregulloret e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës ("BQK").

Baza për opinionin

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në paragrafin Përgjegjësia e Auditorit për auditimin e pasqyrave financiare të raportit tonë. Ne jemi të pavarur nga Banka në pajtim me Kodin e Etikës për Profesionistët Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistët Kontabël ("Kodi BSNEPK") së bashku me kërkesat etike që janë të përshtatshme për auditimin e pasqyrave financiare në Kosovë, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe të Kodit BSNEPK. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Theksim çështje - Baza kontabël dhe kufizimi i përdorimit

Ne tërheqim vëmendjen për Shënimin 2 të pasqyrave financiare, i cili përshkruan bazën kontabël. Pasqyrat financiare janë përgatitur për të ndihmuar Bankën që të jetë në përputhshmëri me kërkesat e raportimit financiar të "Rregullave dhe Rregulloreve" të përmendura më sipër. Si rezultat i kësaj, pasqyrat financiare mund të mos jenë të përshtatshme për ndonjë qëllim tjetër.

Raporti ynë i auditimit ka për qëllim vetëm për informim dhe përdorim të Bankës dhe Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës dhe nuk duhet të përdoret nga palë të tjera përveç Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës. Opinioni ynë nuk është modifikuar për sa i përket kësaj çështjeje.

Përgjegjësitë e menaxhmentit dhe të personave që janë të ngarkuar me qeverisjen për pasqyrat financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me rregullat dhe rregulloret e BQK-së, dhe për ato kontrole të brendshme, që menaxhmenti i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Bankës për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur menaxhmenti synon ta likuidojë Bankën ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Personat që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Bankës.

Përgjegjësitë e auditorit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer në përputhje me SNA-të do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- ▶ Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontroleve të brendshme.
- ▶ Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm, që ka të bëjë me auditimin me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionimi mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Bankës.
- ▶ Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga Menaxhmenti.
- ▶ Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Bankës për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e auditorit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Banka të ndërpresë veprimtarinë.
- ▶ Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në to në një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me ata që janë të ngarkuar me qeverisjen e Banka për Biznes Sh.a, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Ernst & Young Certified Auditors Kosovo
Ernst & Young Certified Auditors Kosovo sh.p.k
6 prill 2018
Prishtinë, Kosovë

Banka për Biznes Sh.a.
Pasqyra të Ardhurave Gjithëpërfshirëse
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017


<i>Në mijë Euro</i>	Shënimet	2017	2016
Të ardhurat nga interesi	6	11,387	9,821
Shpenzimet e interesit	6	(1,741)	(1,670)
Të ardhurat neto nga interesi		9,646	8,151
Të ardhurat nga tarifa dhe komisionet	7	2,309	2,000
Shpenzimet e tarifës dhe komisionet	7	(653)	(522)
Të ardhurat neto nga tarifa dhe komisionet		1,656	1,478
Kthimi nga kreditë e shlyera		690	583
Fitimi neto nga këmbimi valutor		12	(2)
Fitimi nga shitja e letrave me vlerë		1,065	1,878
Të ardhurat e tjera operative	8	790	35
Gjithsej të ardhura operative		13,859	12,123
Humbjet nga kreditë të rëna në vlerë	15	(515)	(1,045)
Kthimi i provizionit për kërkesat ndaj garancioneve		27	10
Ulja e vlerës së pasurive të riposeduara	18	(197)	(529)
Provizionet tjera		(123)	(622)
Shpenzimet tjera operative	9	(6,885)	(5,622)
Gjithsej shpenzimet operative		(7,693)	(7,808)
Fitimi para tatimit në fitim		6,166	4,315
Shpenzimet e tatimit në fitim	10	(634)	(365)
Fitimi neto për vitin		5,532	3,950
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse			
<i>Zërat që janë apo mund të ri-klasifikohen në fitim apo humbje</i>			
Rezerva për vlerën e drejtë (pasuritë financiare për shitje)		2	(14)
Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse për vitin		5,534	3,936

Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse lexohet së bashku me shënimet e shpalosura nga faqe 5 deri 58, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Banka për Biznes Sh.a.
Pasqyra e Pozicionit Financiar
Më 31 dhjetor 2017

<i>Në mijë Euro</i>	Shënimet	2017	2016
Pasuritë			
Paraja e gatshme dhe në banka	11	17,833	12,691
Gjendja me Bankën Qendrore të Kosovës	12	33,998	27,248
Kreditë dhe paradhëniet për banka	13	1,450	600
Letrat më vlerë të mbajtura për shitje	14	17,152	18,267
Kreditë dhe paradhëniet për klientët	15	131,314	101,885
Pasuritë tjera financiare	16	143	237
Pasuritë e tjera	17	815	141
Pasuritë e ri-poseduara	18	155	898
Pasuritë e paprekshme	19	338	226
Prona dhe pajisjet	20	1,725	980
Gjithsej pasuritë		204,923	163,173
Detyrimet			
Depozitat nga klientët	21	177,780	140,598
Kreditë e varura	22	840	1,845
Huamarrjet	22	4,143	4,248
Detyrimet tjera	23	1,673	1,346
Provizione tjera	23	506	404
Gjithsej detyrimet		184,942	148,441
Ekuiteti			
Kapitali aksionar	24	11,247	11,247
Rezerva për vlerën e drejtë		(30)	(32)
Fitimi/(humbja) e akumuluar		8,764	3,517
Gjithsej ekuiteti		19,981	14,732
Gjithsej detyrimet dhe ekuiteti		204,923	163,173

Këto pasqyra financiare janë miratuar nga menaxhmenti i Bankës më 26 mars 2018 dhe nënshkruar në emër të tyre nga:



Arton Celina
Kryeshef Ekzekutiv



Avni Berisha
Udhëheqës i Departamentit të
Financave

Pasqyra e pozicionit financiar lexohet së bashku me shënimet e shpalosura nga faqe 5 deri 58, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Banka për Biznes Sh.a.
Pasqyra e Ndryshimeve në Ekuitet
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

<i>Në mijë Euro</i>	Kapitali aksionar	(Humbjet)/fitimet e akumuluar	Rezerva e vlerës së drejte	Gjithsej
Gjendja më 1 janar 2016	11,247	(433)	(18)	10,796
Transaksionet me aksionarët e Bankës				
<i>Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse</i>	-	-	-	-
Fitimi i vitit	-	3,950	-	3,950
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse (rezerva e vlerës së drejtë)	-	-	(14)	(14)
Gjithsej të ardhurat/(humbjet) tjera gjithëpërfshirëse	-	3,950	(14)	3,936
Gjendja më 31 dhjetor 2016	11,247	3,517	(32)	14,732
Transaksionet me aksionarët e Bankës				
Dividenda e shpërndarë tek aksionarët	-	(285)	-	(285)
<i>Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse</i>	-	-	-	-
Fitimi i vitit	-	5,532	-	5,532
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse (rezerva e vlerës së drejtë)	-	-	2	2
Gjithsej të ardhurat/(humbjet) tjera gjithëpërfshirëse	-	5,247	2	5,249
Gjendja më 31 dhjetor 2017	11,247	8,764	(30)	19,981

Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet duhet të lexohet se bashku me shënimet e shpalosura nga faqe 5 deri 58, të cilat janë pjesë përbërëse të këtyre pasqyrave financiare.

Banka për Biznes Sh.a.**Pasqyra e Rrjedhës së Parasë**

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

<i>Në mijë Euro</i>	Shënimet	2017	2016
Rrjedhja e parasë nga aktivitetet operative			
Fitimi i vitit para tatimit		6,166	4,315
<i>Zërat jo-monetar në pasqyra financiare:</i>			
Zhvlerësimi	20	351	321
Amortizimi	19	133	77
Fitimi nga shitja e pronave dhe pajisjeve		(160)	(21)
Fitimi nga kolaterali i riposeduar		(601)	-
Humbjet nga kreditë të rëna në vlerë	15	515	1,045
Rënia në vlerë për pasuritë e ri poseduara	18	197	529
Provizione tjera		123	395
Fitimi nga shitja e letrave me vlerë		(1,065)	(1,878)
Shpenzimet e interesit	6	1,741	1,670
Të ardhurat nga interesi	6	(11,387)	(9,821)
		(3,987)	(3,368)
Ndryshimet në:			
Kredi dhe paradhënie për bankat	13	(850)	360
Kredi dhe paradhënie për klientët	15	(28,884)	(16,524)
Rezerva e detyrueshme në BQK	12	(2,674)	(3,248)
Pasuritë tjera	17	(674)	(19)
Pasuritë tjera financiare	16	94	54
Pasuritë e ri poseduara	18	694	-
Depozitat nga klientët	21	37,056	24,723
Detyrimet dhe provizionet tjera	23	313	643
Interesi i arkëtuar		11,288	9,967
Interesi i paguar		(1,746)	(1,684)
Tatimi në fitim i paguar		(565)	(290)
Paraja neto e gjeneruar nga aktivitetet operative		10,065	10,614
Rrjedhja e parasë nga aktivitetet investuese			
Investimet në pasuritë financiare të mbajtura për shitje	14	1,886	(7,927)
Blerja e pronave dhe pajisjeve	20	(1,105)	(276)
Blerja e pasurive të paprekshme	19	(245)	(156)
Të hyrat nga shitja e pronave dhe pajisjeve		2	37
Paraja neto e gjeneruar nga aktivitetet investuese		538	(8,322)
Rrjedhja e parasë nga aktivitetet financuese			
Pagesa e huamarrjeve	22	(2,600)	(800)
Inkasimet nga huamarrjet		1,500	2,000
Dividenda e shpërndarë		(285)	-
Paraja neto e gjeneruar nga aktivitetet financuese		(1,385)	1,200
Rritja neto e parasë dhe ekuivalentëve të saj		9,218	3,492
Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj në fillim të vitit	11	27,646	24,154
Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj në fund të vitit	11	36,864	27,646

Pasqyra e rrjedhës së parasë lexohet së bashku me shënimet e shpalosura nga faqe 5 deri 58 të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Banka për Biznes Sh.a.

Shënimet e pasqyrave financiare

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Shumat janë në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

1. HYRJE

Banka Private e Biznesit Sh.a (“BPB”) ka marr licencën për aktivitetet bankare me 29 mars 2001, dhe ka filluar operimin me 24 prill 2001.

Bazuar në vendimin e Bordit të Drejtorëve të datës 28 shkurt 2005 dhe miratimit final nga BQK-ja me datë 22 mars 2005, BPB ka ndryshuar emrin nga Banka Private e Biznesit (“BPB”) në Banka për Biznes (“Banka”). Në vitin 2006, Banka është regjistruar si shoqëri aksionare (“Sh.a”) në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë së Kosovës. Banka operon si një bankë komerciale dhe e kursimeve për të gjitha kategoritë e konsumatorëve brenda Kosovës nëpërmjet rrjetit të 8 degëve dhe 19 nëndegëve të saj të vendosura nëpër tërë Kosovën (2016:7 degë dhe 19 nëndegë).

2. BAZAT E PËRGATITJES

a) Pasqyra e pajtueshmërisë

Këto pasqyra janë përgatitur në pajtim me Nenin 53 të Ligjit nr. 04/L-093, të datës 11 maj 2012, “Ligji për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jo bankare”.

Pasqyrat financiare janë përgatitur për qëllime rregullatorë dhe pasqyrojnë rregullat dhe rregulloret e kontabilitetit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (“Rregullat e BQK-së”). Rregullat e BQK-së bazohen në vendimet relevante ligjore që definojnë aplikimin e detyrueshëm të Standardeve Ndërkombëtare për Raportim Financiar (“SNRF”) në Kosovë, por rregullat e BQK-së në veçanti kërkojnë zbatimin e disa trajtimeve të kontabilitetit të cilat nuk janë në përputhje me kërkesat e veçanta të SNRF-së. Rrjedhimisht, këto pasqyra financiare duhet të lexohen si të përgatitura në pajtim me standardet e kontabilitetit dhe rregulloret që janë në fuqi në territorin e Kosovës, siç është paraqitur në politikat e rëndësishme kontabël në shënimin 3 më poshtë.

b) Bazat e përgatitjes

Këto pasqyra financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike, përveç letrave më vlerë të mbajtura për shitje, të cilat janë matur me vlerën e drejtë.

c) Valuta funksionale dhe raportuese

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Euro e cila është valutë funksionale e Bankës. Të gjitha shumat janë rrumbullaksuar në mijëshen më të afërt përveç kur ceket ndryshe.

d) Përdorimi i gjykimeve dhe i vlerësimeve

Në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare, menaxhmenti ka bërë gjykime, vlerësime dhe supozime që ndikojnë në zbatimin e politikave kontabël të Bankës dhe mbi shumat e raportuara të pasurive, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të kenë ndryshime nga këto vlerësime.

Vlerësimet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve njihen në mënyrë prospektive.

Informacionet mbi elementët e rëndësishëm me pasiguri në vlerësime dhe gjykimet kritike në zbatimin e politikave kontabël me efekt të konsiderueshëm në vlerat kontabël në pasqyrat financiare janë përshkruar në shënimin 3, 5 dhe 26.

Banka për Biznes Sh.a.

Shënimet e pasqyrave financiare

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Shumat janë në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

3. POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL

Politikat e kontabilitetit të paraqitura më poshtë janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në këto pasqyra financiare.

a) Interesi

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi njihen në fitim ose humbje me metodën e interesit efektiv. Norma e interesit efektiv është norma që bënë aktualizimin e flukseve të pagesave të arkëtimeve të pritshme në të ardhmen gjatë jetëgjatësisë së pritshme të pasurisë ose detyrimit financiar (ose sipas rastit mund të jetë një periudhë më e shkurtër) deri në shumën e bartur të pasurisë ose detyrimit financiar. Gjatë llogaritjes së normës efektive të interesit, Banka vlerëson rrjedhat e ardhshme të parasë duke marrë parasysh të gjitha kushtet kontraktuale të instrumentit financiar por jo humbjet e ardhshme të kredisë.

Llogaritja e normës efektive të interesit përfshin të gjitha kostot e transaksionit dhe komisionet e zbritjet e tjera të paguara ose pranuar, të cilat janë pjesë integrale e normës së interesit efektiv. Kostot e transaksionit përfshijnë kostot shtesë që janë direkt të lidhura me blerjen apo emetimin e një pasurie apo detyrimi financiar.

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi të paraqitura në pasqyrën e ardhurave tjera gjithëpërfshirëse përfshijnë:

- Interesi nga pasuri ose detyrime financiare matur me koston e amortizuar të llogaritur mbi bazën e interesit efektiv; dhe
- Interesi nga investime të mbajtura për shitje të llogaritura mbi bazën e interesit efektiv.

b) Tarifa dhe komisione

Të ardhurat dhe shpenzimet për tarifatat dhe komisionet të cilat janë pjesë përbërëse e normës efektive të interesit në një pasuri, detyrim financiar, përfshihen në matjen e normës efektive të interesit.

Të ardhura e tjera nga tarifatat dhe komisionet, përfshirë edhe tarifatat e shërbimeve të llogarive, tarifatat e transferimit të fondeve si dhe komisionet e shitjeve dhe tarifa për vendosje me afat në Banka, njihen me kryerjen e shërbimeve të lidhura me to.

Kur një angazhim për kreditim nuk pritet të rezultojë në tërheqjen e kredisë, komisionet e kredisë përkatëse njihen në bazë lineare përgjatë periudhës së angazhimit.

Shpenzimet e tjera për tarifa dhe komisione lidhen kryesisht me komisione për transaksione dhe shërbime, të cilat regjistrohen si shpenzim në momentin e pranimit të shërbimit.

c) Pagesat e qirasë

Pagesat për qiranë operative njihen në fitim ose humbje në bazë lineare përgjatë afatit të qirasë. Zbritjet nga qiraja njihen si pjesë përbërëse e totalit të shpenzimit për qira, përgjatë afatit të qirasë.

d) Shpenzimet e tatimit

Shpenzimet e tatimit përfshijnë tatimin aktual dhe të shtyrë. Tatimi aktual dhe tatimi i shtyrë njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes të periudhës me përjashtim të rasteve që lidhen me zëra që njihen direkt në ekuitet ose në pasqyrën e të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse.

(i) Tatimi aktual

Tatimi aktual përfshin tatimin që pritet të paguhet ose arkëtohet për të ardhurat ose humbjet e tatueshme për periudhën, duke përdorur normat në fuqi në datën e raportimit dhe çdo rregullim të tatimit që duhet të paguhet ose arkëtohet në lidhje me vitet e mëparshme.

(ii) Tatimi i shtyrë

Tatimi i shtyrë njihet mbi diferencat e përkohshme që dalin midis bazës tatimore dhe vlerës kontabël neto të pasurive dhe detyrimeve në pasqyra financiare. Tatimi i shtyrë nuk njihet për diferencat e përkohshme që lindin me rastin e njohjes fillestare të pasurive ose detyrimeve të transaksioneve që nuk përbëjnë një kombinim biznesi dhe që nuk ndikojnë as në fitimin, as në humbjen kontabël dhe as në atë të tatueshme.

Banka për Biznes Sh.a.

Shënimet e pasqyrave financiare

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Shumat janë në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

3. POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

d) Shpenzimet e tatimit (vazhdim)

(ii) Tatimi i shtyrë (vazhdim)

Matja e tatimit të shtyrë reflekton pasojat tatimore që do ta përcjellin mënyrën në të cilën Banka pret në fund të periudhës raportuese që të mbulojë apo vendosë vlerën kontabël të mjeteve dhe detyrimeve të saj.

Tatimi i shtyrë matet sipas normave tatimore që priten të aplikohen në diferencat e përkohshme kur ato kthehen, përmes normave tatimore në fuqi në datën e raportimit.

Pasuritë dhe detyrimet tatimore të shtyra kompensohen ndërmjet tyre nëse ka një të drejtë ligjore për ta kompensuar me mjetin dhe detyrimin e tatimit dhe kur ndërlidhen me tatimet e pagueshme kundrejt autoritetit të njëjtë tatimor.

Tatimet shitesë që vijnë si rezultat i shpërndarjes së dividendës nga ana e Bankës njihen në të njëjtën kohë kur edhe njihen detyrimet për ta paguar dividendën respektive.

Një pasuri tatimore e shtyrë njihet për humbjet sipas tatimeve, kredive tatimore dhe dallimet e përkohshme të zbritshme të pashfrytëzuara, vetëm në atë masë që është e mundur të shfrytëzohet për fitimet e ardhshme të tatueshme kundër të cilave mund të shfrytëzohet kjo pasuri. Pasuritë e tatimit të shtyrë rishikohen në secilën datë të raportimit dhe reduktohen në atë masë që nuk është më e mundur që përfitimet nga tatimi të realizohen.

(iii) Ekspozimet tatimore

Në përcaktimin e shumës së tatimit aktual dhe të shtyrë, Banka merr parasysh ndikimin e pozicioneve tatimore të pasigurta dhe nëse tatimi apo interesat shitesë mund të jenë të pagueshme. Ky vlerësim mbështetet në vlerësime dhe supozime dhe mund të përfshijë një sërë gjykimesh në lidhje me ngjarjet e ardhshme. Informacione të reja mund të bëhen të disponueshme dhe të bëjnë që Banka të ndryshojë vendimin e saj në lidhje me adekuatshmërinë e detyrimeve tatimore ekzistuese; këto ndryshime në detyrimet tatimore do të ndikojnë në shpenzimet tatimore në periudhën në të cilën është bërë një përcaktim i tillë.

e) Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj rivlerësohen në monedhën funksionale përkatëse të Bankës me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Pasuritë dhe detyrimet në valutë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të asaj date.

Fitimi ose humbja nga zërat monetar është diferenca ndërmjet kostove të amortizuara në valutë funksionale në fillim të periudhës, e rregulluar për interesin efektiv dhe pagesat gjatë periudhës si dhe kostos së amortizuar në monedhë të huaj me kursin e këmbimit në fundin e vitit.

Pasuritë dhe detyrimet jo-monetare në valutë të huaj që maten me vlerën e drejtë janë konvertuar në valutën funksionale me kursin e këmbimit në datën kur është përcaktuar vlera e drejtë. Zërat jo-monetarë që maten në bazë të kostos historike në valutë të huaj, konvertohen duke përdorur kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Diferencat që lindin nga rivlerësimi njihen në fitim ose humbje.

f) Pasuritë financiare dhe detyrimet financiare

(i) Njohja

Banka fillimisht nje kreditë dhe paradhëniet, investimet e mbajtura deri në maturitet dhe të vlefshme për shitje, depozitat, huamarrjet dhe borxhet e ndërvarura në datën që ato janë krijuar. Blerjet dhe shitjet e pasurive financiare njihen me datën e tregtimit në të cilën Banka angazhohet për të blerë ose shitur pasurinë. Të gjitha pasuritë dhe detyrimet e tjera financiare njihen fillimisht në datën e tregtimit, e cila është data kur Banka bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit.

Një pasuri ose detyrim financiar fillimisht matet me vlerën e drejtë plus kostot e transaksionit që lidhen drejtpërdrejtë me blerjen apo lëshimin e tij.

Banka për Biznes Sh.a.

Shënimet e pasqyrave financiare

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Shumat janë në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

3. POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

f) Pasuritë financiare dhe detyrimet financiare (vazhdim)

(ii) Klasifikimi

Pasuritë financiare

Banka klasifikon pasuritë e saj financiare në një nga kategoritë e mëposhtme:

- Hua dhe llogari të arkëtueshme;
- Letrat me vlerë të mbajtura për shitje

Shiko shënimet 3(h), dhe (i) .

Detyrimet financiare

Banka klasifikon detyrimet e saj financiare si të matura me kosto të amortizuar.

(iii) Ç' regjistrimi

Pasuritë financiare

Banka çregjistron një pasuri financiare kur mbarojnë të drejtat kontraktuale për rrjedhjet e parave nga pasurie financiare ose transferon të drejtat për të marrë rrjedhje të parave kontraktuale në një transaksion në të cilin kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së pasurisë financiare janë transferuar ose në të cilat Banka as nuk transferon e as nuk ruan në thelb të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë dhe nuk mban kontrollin e pasurisë financiare. Çdo interes në pasuritë financiare të transferuara që kualifikohen për ç' regjistrim që është krijuar apo mbajtur nga Banka njihet si një pasuri ose detyrim në vete.

Në momentin e ç' regjistrimit të një pasurie financiare, diferenca mes vlerës kontabël neto të pasurisë (ose vlera kontabël që i përket pjesës së pasurisë së transferuar), dhe totalit të (i) konsideratës së marrë (përfshirë çdo pasuri të re të përfituar ose detyrim të supozuar) dhe (ii) çdo fitimi ose humbje kumulative që është njohur në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse, njihet në fitim ose humbje.

Detyrimi financiar

Banka ç' regjistron një detyrim financiar kur obligimet kontraktuale shlyhen, anulohen ose kanë përfunduar.

(iv) Netimi

Pasuritë dhe detyrimet financiare netohen dhe shuma neto paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar, atëherë, dhe vetëm atëherë kur Banka ka të drejtën ligjore për të netuar shumat dhe ajo synon ose të shlyejë ato në një bazë neto ose të realizojë pasurinë dhe të shlyejë detyrimin njëkohësisht.

Të ardhurat dhe shpenzimet paraqiten në bazë neto vetëm atëherë kur lejohet sipas SNRF, apo për fitimet dhe humbjet që vijnë nga një grup i transaksioneve të ngjashme sikurse nga aktiviteti komercial i bankës.

(v) Matja me kosto të amortizuar

'Kosto e amortizuar' e një pasurie ose detyrimi financiar është vlera me të cilën pasuria ose detyrimi financiar matet në njohjen fillestare, minus shlyerjet e principalit, plus ose minus amortizimin e akumuluar duke përdorur metodën e interesit efektiv për çdo diferencë ndërmjet vlerës fillestare të njohur dhe vlerës në maturim, minus çdo zbritje për efekt zhvlerësimi.

(vi) Matja e vlerës së drejtë

'Vlera e drejtë' është çmimi me të cilin pasuria mund të shitet, ose një detyrim të transferohet, në një transaksion të zakonshëm mes pjesëmarrësve në treg në datën e matjes, në një treg primar ose në mungesë të tij, në tregun më të favorshëm ku Banka ka qasje në atë datë. Vlera e drejtë e një detyrimi pasqyron riskun e mosekzekutimit të tij.

Banka për Biznes Sh.a.

Shënimet e pasqyrave financiare

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Shumat janë në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

3. POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

f) Pasuritë financiare dhe detyrimet financiare (vazhdim)

(vi) Matja e vlerës së drejtë (vazhdim)

Kur është e mundur, Banka përcakton vlerën e drejtë të një instrumenti duke përdorur çmimin e kotuar në treg aktiv për instrumentin. Tregu quhet aktiv kur transaksionet lidhur me pasurinë apo detyrimin ndodhin shumë shpesh dhe me volum të mjaftueshëm për të siguruar informacion të vazhdueshëm për çmimin.

Kur nuk ekziston një çmim i kuotuar në një treg aktiv Banka përdor teknika vlerësimi që maksimizojnë përdorimin e inputeve të vëzhgueshme dhe minimizojnë përdorimin e inputeve jo të vëzhgueshme. Teknika e zgjedhur e vlerësimit përfshin gjithë faktorët që pjesëmarrësit në treg do të konsideronin në vendosjen e çmimit të një transaksioni.

Evidenca më e mirë e vlerës së drejtë të një instrumenti financiar me njohjen fillestare të tij është zakonisht çmimi i transaksionit –për shembull; vlera e drejtë e konsideratës së dhënë ose të marrë. Nëse Banka vendos se vlera e drejtë në njohjen fillestare ndryshon nga çmimi i transaksionit dhe se vlera e drejtë nuk është evidentuar as me një çmim të kuotuar në një treg aktiv për një pa ose detyrim identik, e as nuk është e bazuar në një teknikë vlerësimi që përdor vetëm të dhëna nga tregjet të vrojtueshme në treg, atëherë instrumenti financiar matet fillimisht me vlerën e drejtë, rregulluar për të shtyrë në kohë diferencën midis vlerës së drejtë në njohjen fillestare dhe çmimit të transaksionit. Më pas, kjo diferencë është njohur në fitim ose humbje në një bazë të përshtatshme mbi jetën e instrumentit por jo më vonë se vlerësimi që mbështetet plotësisht nga të dhëna të vëzhgueshme të tregut ose kur transaksioni mbyllet.

Nëse një pasuri ose detyrim i matur me vlerën e drejtë ka çmim të ofruar dhe çmim të kërkuar, Banka mat pasuritë dhe pozicionet e gjata me çmimin e ofruar dhe detyrimet dhe pozicionet e shkurtra me çmim të kërkuar.

Vlera e drejtë e një depozite pa afat nuk është më e vogël se shuma që paguhet në momentin e kërkesës, e cila zbritet nga data e parë kur mund të kërkohej pagesa e depozitës.

Banka njih transferimet midis niveleve të hierarkisë së vlerës së drejtë deri në fund të periudhës raportuese gjatë së cilës ka ndodhur ky ndryshim.

(vii) Identifikimi dhe matja e zhvlerësimit

Zhvlerësimi i huave dhe paradhënieve

Në çdo datë raportimi Banka vlerëson nëse ka evidencë objektive që pasuritë financiare të cilat nuk mbahen me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes janë provizionuar. Një pasuri financiar ose një grup pasurish financiar është provizionuar kur evidenca objektive demonstroi se një ngjarje që sjell humbje ka ndodhur pas njohjes fillestare të pasurisë dhe që ngjarja që sjell humbje ka një ndikim në rrjedhat e ardhshme të parasë të pasurisë ose grupeve të pasurive dhe që mund të vlerësohet me besueshmëri.

Evidenca objektive që pasuritë financiare janë provizionuar mund të përfshijnë vështirësi financiare të konsiderueshme të huamarrësit ose emetuesit, mos pagesa nga huamarrësit, ristrukturimin e një kredie apo paradhënie nga Banka me kushte që Banka nuk do t'i kishte konsideruar, indikacione që një huamarrës ose huadhënës po falimenton, zhdukja e një tregu aktiv për një letër me vlerë ose të dhëna të tjera të dukshme lidhur me një grup pasurish të tilla si ndryshimet negative në statusin e pagesave të huamarrësit ose emetuesit në grup, apo kushtet ekonomike që tregojnë me dështimin në bankë.

Provizionet për humbjet nga kreditë përcaktohen sipas rregullores “Menaxhimi i Riskut Kreditor” e cila është aprovuar nga BQK-ja me 26 Prill 2013. Rregullorja kërkon që Banka të klasifikojë ekspozimet në pesë kategori të riskut. Banka i zhvlerëson kreditë dhe paradhëniet përmes zhvlerësimit specifik dhe të përgjithshëm. Kreditë dhe paradhëniet që janë dëmtuar në mënyrë specifike përfshijnë ekspozimet të rëndësishme më shumë se 50,000 Euro. Kreditë dhe paradhëniet që nuk janë të zhvlerësuara në mënyrë specifike zhvlerësohen në mënyrë kolektive duke i grupuar së bashku kreditë dhe paradhëniet me karakteristika të ngjashme të riskut.

Banka për Biznes Sh.a.

Shënimet e pasqyrave financiare

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Shumat janë në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

3. POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

f) Pasuritë financiare dhe detyrimet financiare (vazhdim)

(vii) Identifikimi dhe matja e zhvlerësimit (vazhdim)

Provizionet për humbjet e mundshme në kredi të klasifikuara si standarde dhe në vëzhgim janë klasifikuar si provizione të përgjithshme. Në përputhje me politikat e brendshme të Bankës për provizionim, norma e cila zbatohet për kategorinë standarde është 0.65 % (2016: 0.77 %) dhe për kategorinë në vëzhgim është 3.06 % (2016: 3.56 %). Për çdo kategori të riskut, normat e mëposhtme minimale të provizionimit janë aplikuar:

Kategoria	Norma minimale e provizionimit
Nën standarde	20%
Dyshimtë	50%
Humbje	100%

Humbjet njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe pasqyrohen në një llogari provizioni kundrejt huave dhe paradhënies. Kreditë shlyhen pasi janë ndërmarrë masat e arsyeshme të mbledhjes në përputhje me politikën e Bankës.

Kur një ngjarje pasuese shkakton që shuma e humbjes nga zhvlerësimi të ulet, atëherë ulja e humbjes nga zhvlerësimi kthehet nëpërmjet pasqyrës së të ardhurave gjithëpërfshirëse.

Zhvlerësimi i pasurive financiare të mbajtura për shitje

Banka vlerëson në çdo datë raportimi nëse ka evidencë objektive që një pasuri financiare ose një grup pasurish financiare është zhvlerësuar. Në rast të investimeve në kapital të klasifikuara si të vlefshme për shitje, një rënie e ndjeshme ose e shtrirë në vlerën e drejtë të letrave me vlerë nën koston e tij është konsideruar në përcaktimin nëse pasuritë janë zhvlerësuar ose jo. Në qoftë se, në një periudhë në vijim, vlera e drejtë e një instrumenti të borxhit të klasifikuar si i vlefshëm për shitje rritet, dhe rritja mund të lidhet objektivist me një ngjarje që ndodh pas humbjes nga zhvlerësimi është njohur në fitim ose humbje, humbja nga zhvlerësimi kthehet nëpërmjet fitimit ose humbjes.

g) Paraja dhe ekuivalentet e pasasë

Paraja dhe ekuivalentët e saj përfshijnë monedhat dhe kartëmonedhat në arkë, gjendjet në Bankën Qendrore të pakufizuara në përdorimin e pasurive financiare shumë likuide me maturim fillestar deri në tre muaj të cilat, kanë risk të pa konsiderueshëm ndryshimi të vlerës së tyre të drejtë, dhe përdoren nga Banka për menaxhimin e angazhimeve afatshkurtra. Paraja dhe ekuivalentet e saj mbahen me kosto të amortizuara në pasqyrën e pozicionit financiar.

h) Investimet e mbajtura për shitje

Letrat me vlerë maten fillimisht me vlerën e drejtë plus kostot direkte të transaksionit.

Investimet e mbajtura për shitje janë investime jo-derivative të cilat janë përcaktuar si të vlefshme për shitje ose nuk janë klasifikuar si një kategori tjetër e pasurive financiare. Investimet e mbajtura për shitje përbëhen nga letrat me vlerë të borxhit. Të gjitha investimet e vlefshme për shitje janë matur me vlerën e drejtë, pas njohjes fillestare.

E ardhura nga interesi njihet në fitim ose humbje duke përdorur metodën e interesit efektiv. Fitimet ose humbjet e këmbimit valutator në investimet e vlefshme për shitje njihen në fitim ose humbje. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në fitim ose humbje (shih (f)(vii)).

Ndryshime të tjera të vlerës së drejtë, përveç humbjeve nga zhvlerësimi (shih (f)(vii)), njihen në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirës edhe paraqiten në rezervën e vlerës së drejtë brenda ekuitetit. Kur investimi shitet, fitimi ose humbja e akumuluar në kapital ri klasifikohet në fitim ose humbje.

Banka për Biznes Sh.a.

Shënimet e pasqyrave financiare

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Shumat janë në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

3. POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

i) Kreditë dhe të arkëtueshmet

Kreditë dhe të arkëtueshmet janë pasuri financiare jo-derivative me pagesa fikse ose të përcaktueshme, të cilat nuk janë kuotuar në një treg aktiv dhe Banka nuk ka për qellim ti shes menjëherë apo në një periudhë afatshkurtër. Kreditë dhe paradhëniet për Banka klasifikohen si kredi dhe të arkëtueshme.

Kreditë dhe paradhëniet njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus kostot direkte të transaksionit dhe më pas maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

j) Depozitat dhe huazimet, dhe kreditë e varura

Depozitat, huazimet dhe borxhet e varura janë burimet kryesore të Bankës për financim.

Depozitat, huazimet dhe borxhet e varura maten me vlerën e drejtë minus kostot direkte të transaksionit dhe më pas maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

k) Pasuritë e riposeduar

Pasuritë e ri poseduara janë përfituar nëpërmjet ekzekutimit të kolateralit mbi kreditë dhe paradhëniet me probleme për klientët dhe që nuk fitojnë qira, nuk janë të përdorura nga Banka dhe janë të destinuara për shitje në një periudhë kohore afatshkurtër te arsyeshme. Pasuritë e ri poseduara maten sipas vlerës më të ulët të koston dhe vlerës neto të realizueshme dhe çdo zhvlerësim njihet në fitim ose humbje.

l) Prona dhe pajisjet

(i) Njohja dhe matja

Zërat e pronës dhe pajisjeve janë matur sipas koston minus zhvlerësimin e akumuluar dhe ndonjë humbje nga dëmtimet.

Kostot historike përfshijnë shpenzime që janë drejtpërdrejtë të lidhura me blerjen e pasurisë. Softueri i blerë që është thelbësor për funksionimin e pajisjes përkatëse kapitalizohet si pjesë e asaj pajisje.

Kur pjesë të një elementi të pasurive afatgjata kanë jetëgjatësinë e dobishme të ndryshme, ato llogariten si artikuj të veçantë (përbërësit madhor) të pronës dhe pajisjeve.

Çdo fitim ose humbje nga nxjerrja jashtë përdorimit të një zëri të pronës dhe pajisjeve aktive (llogaritur si diferencë midis të ardhurave neto nga shitja dhe vlerës kontabël neto të zërit), njihet në të ardhura të tjera në fitim ose humbje.

(ii) Kostot pasuese

Kostot pasuese janë kapitalizuar vetëm kur vërtetohet që benefitet ekonomike të ardhshme të atij shpenzimi do të rrjedhin në bankë. Riparimet e vazhdueshme dhe mirëmbajtja janë ngarkuar në shpenzime në periudhën që kanë ndodhur.

(iii) Zhvlerësimi

Zërat e pronës dhe pajisjeve zhvlerësohen nga data kur ato janë në dispozicion për përdorim. Amortizimi llogaritet për të shlyer koston e artikujve të pronës dhe pajisjeve minus vlerat e përlllogaritura të mbetura të këtyre pasurive përgjatë jetës së parashikuar të përdorimit. Zhvlerësimi njihet në fitim ose humbje.

Zhvlerësimi njihet në fitim ose humbje në bazë lineare përgjatë jetës së dobishme të çdo pjese të një zëri të pronës dhe pajisjeve. Jetëgjatësia për periudhën aktuale dhe krahasuese është si vijon:

	Jetëgjatësia
Ndërtesa	20 vite
Kompjuterë dhe pajisje të ngjashme	5 vite
Automjete	5 vite
Mobilje dhe pajisje	5 vite

Përmirësimet e objekteve me qira zhvlerësohen duke përdorur metodën lineare të amortizimit gjatë afatit më të shkurtër të qirasë, dhe të jetës së tyre të dobishme. Jeta e dobishme e përmirësimeve në objektet e marruar me qira është 5 vjet.

Metodat e zhvlerësimit, jetëgjatësia e dobishme dhe vlerat e mbetura janë ri-vlerësuar në datën e raportimit dhe janë rregulluar atëherë kur duhet.

Banka për Biznes Sh.a.

Shënimet e pasqyrave financiare

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Shumat janë në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

3. POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

m) Pasuritë e paprekshme

Softuerët e blerë nga Banka janë matur me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe minus ndonjë humbje nga zhvlerësimi. Shpenzimet e mëvonshme mbi programet kompjuterike kapitalizohen vetëm kur rrisin përfitimet e ardhshme ekonomike të trupëzuara në pasurinë specifike për të cilin lidhen. Të gjitha shpenzimet e tjera njihen kur ndodhin.

Amortizimi njihet në fitim ose humbje gjatë jetës së dobishme të aktivitetit, që nga data që është në dispozicion për përdorim.

Softueri amortizohet duke përdorur metodën lineare gjatë jetës së dobishme prej pesë viteve. Metodatat e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi dhe rregullohen nëse është e përshtatshme.

n) Rënia në vlerë e pasurive jo financiare

Vlera kontabël e pasurive jo-financiare të Bankës, përveç pasurive për tatime të shtyra, rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka ndonjë tregues për zhvlerësim. Nëse ka tregues të tillë atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e pasurisë. Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera kontabël e një pasurie ose e njësisë gjeneruese të mjeteve monetare të saj e tejkalon shumën e saj të rikuperueshme.

Shuma e rikuperueshme e një pasurie ose e njësisë gjeneruese të parasë është më e madhja nga vlera e tij në përdorim dhe vlera e drejtë minus kostojat për shitje. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, rrjedhat e ardhshme të parasë janë skontuar në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi para taksave që reflektojnë vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe risqet specifike për pasurinë.

Humbjet nga dëmtimi janë njohur në fitim apo humbje. Humbja nga rënia në vlerë kthehet deri në atë masë sa vlera kontabël e pasurisë nuk tejkalon vlerën kontabël që do të përcaktohej duke i zbritur amortizimin, në qoftë se nuk është njohur humbja nga zhvlerësimi.

o) Provizionet

Një provizion njihet nëse si pasojë e një ngjarje të mëparshme, ku Banka ka një obligim ligjor aktual apo konstruktiv që mund të vlerësohet me saktësi, dhe ka mundësi që një dalje e të mirave materiale do të kërkohet për të shlyer obligimin. Provizionet përcaktohen duke skontuar të rrjedhve të ardhshme të parasë të pritura me një normë para tatimit e cila reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën e parasë në kohë dhe sipas rastit, me rreziqet specifike të detyrimit. Diskontimi i pashmangshëm njihet si kosto financiare.

p) Përfitimet e punonjësve

(i) Planet e përcaktuara të kontributeve

Detyrimet për kontributet në planet e përcaktuara të kontributeve njihen si shpenzim në fitim ose humbje kur ato ndodhin. Banka paguan vetëm kontribute për sigurimet shoqërore të detyrueshme që ofrojnë përfitime në formë të pensioneve për punonjësit me rastin e pensionimit. Autoritetet lokale janë përgjegjëse për përcaktimin e limitit minimal ligjor të vendosur për pensionet në Kosovë sipas një plani të përcaktuar të kontributeve për pensione.

(ii) Përfitimet afatshkurtëra

Detyrimet për përfitimet afatshkurtra të punëtorëve maten mbi një bazë të paskontuar dhe njihen si shpenzime në momentin e ofrimit të shërbimit. Një provizion njihet për shumën që pritet të paguhet sipas një bonusi afatshkurtër në të holla ose sipas planit për ndarjen e fitimit nëse Banka ka një detyrim ligjor aktual ose konstruktiv për të paguar këtë vlerë si rezultat i shërbimeve në të kaluarën të ofruara nga punonjësi me ç'rast detyrimi mund të vlerësohet me saktësi.

Banka për Biznes Sh.a.

Shënimet e pasqyrave financiare

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Shumat janë në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

3. POLITIKAT E RËNDËSISHME EKONTABËL (VAZHDIM)

q) Garancionet financiare dhe zotimet për hua

Garancionet financiare janë kontrata që e detyrojnë Bankën që të bëjë pagesa specifike për të rimbursuar mbajtësin për një humbje që lind kur një debitor specifik nuk paguan në afat sipas termave të një instrumenti huadhënës. Angazhimet për hua janë angazhimet e përcaktuara për të siguruar kredi sipas termave dhe kushteve të para-përcaktuara. Angazhime të tilla financiare regjistrohen në pasqyrën e pozicionit financiar, nëse dhe kur ato bëhen të pagueshme.

r) Dividendët

Dividendët nga aksionet e zakonshme njihen në ekuitet në periudhën në të cilën ato janë miratuar nga aksionarët e bankës. Dividendët për vitin që janë deklaruar pas datës së raportimit janë paraqitur si ngjarje pas përfundimit të periudhës së raportimit.

s) Rezervat e ekuitetit

Rezervat e regjistruara në ekuitet në pasqyrën e pozicionit financiar të Bankës përbëhen nga:

- Rezerva e të gatshmeve për shitje, që përfshin ndryshimet në vlerën e drejtë të investimeve të gatshme për shitje;
- Rezerva tjetër të kapitalit, që përfshin dallimin ndërmjet humbjeve të akumuluar sipas SNRF dhe BQK;
- Rezerva e rivlerësimit, që përfshin kolateralin e ri poseduar të regjistruar në pasuri dhe pajisje nga Banka.

Banka për Biznes Sh.a.

Shënimet e pasqyrave financiare

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Shumat janë në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

Menaxhmenti diskuton me Komitetin e Auditimit; zhvillimin, zgjedhjen dhe paraqitjen e politikave kontabël kritike të Bankës dhe zbatimin e tyre si dhe supozimet e bëra në lidhje me pasiguritë e mëdha të vlerësimit. Informacioni në lidhje me supozimet dhe vlerësimet e pasigurive që kanë një risk të rëndësishëm të rezultojnë në një rregullim material brenda vitit të ardhshëm financiar dhe për gjykimet kritike në aplikimin e politikave kontabël që kanë efektin më të rëndësishëm në shumat e njohura në pasqyrat financiare të veçanta janë shpalosur më poshtë.

Këto shënime shpjeguese mbështesin komentet mbi menaxhimin e riskut financiar (shih shënimin 26).

a) Provizionimi

Pasuritë e llogaritura me kosto të amortizuara vlerësohen për provizionim në bazë të politikave të përshkruara të kontabilitetit shih shënimin 3 (f) (vii).

Banka rishikon portofolin e saj të kredive për të vlerësuar provizionimin në baza të rregullta. Në përcaktimin nëse një humbje nga provizionimi duhet të regjistrohet në pasqyrën e të ardhurave apo jo, Banka gjykon nëse ka të dhëna që tregojnë se ka një rënie të matshme në rrjedhat e ardhshme të parasë nga portofolio e kredive para se rënia mund të identifikohet me një kredi individuale në atë portofolio. Kjo evidencë mund të përfshijë të dhëna që tregojnë se ka pasur një ndryshim negativ në statusin e pagesave të huamarrësve në grup apo në kushtet ekonomike kombëtare ose lokale që lidhen me mungesa në pasuritë e Bankës.

Menaxhmenti përdor vlerësime të bazuara nga përvojën historike të humbjeve për pasuritë karakteristika të riskut të kredisë dhe prova objektive të zhvlerësimit të ngjashme me ato në portofolion kur bëhet caktimi i rrjedhave të ardhshme të parasë. Metodologjia dhe supozimet e përdorura për vlerësimin e shumës dhe kohën e rrjedhës së ardhshme të parasë rishikohen rregullisht për të zvogëluar ndonjë diferencë midis vlerësimeve të humbjeve dhe përvojës aktuale të humbjes.

Banka përcakton se investimet në dispozicion për shitje zhvlerësohen kur ka pasur një rënie të konsiderueshme ose të zgjatur në vlerën e drejtë nën koston e tyre. Ky përcaktim se çfarë është e rëndësishme ose e shtyrë kërkon gjykim. Në marrjen e këtij gjykimi, Banka vlerëson në mesin e faktorëve të tjerë, paqëndrueshmërinë normale në çmimin e aksionit. Përveç kësaj, zhvlerësimi mund të jetë i përshtatshëm kur ka prova të përkeqësimit në shëndetin financiar të investuarit, performancës së industrisë dhe të sektorit, ndryshimet në teknologji dhe rrjedhat operative dhe të financimit të mjeteve monetare.

Banka për Biznes Sh.a.

Shënimet e pasqyrave financiare

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Shumat janë në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

5. PËRDORIMI I VLERËSIMEVE DHE GJYKIMEVE (VAZHDIM)

b) Vlera neto e realizueshme e pasurive të ri poseduara

Banka ka krijuar një politikë në lidhje me vlerat e drejta të pasurive të riposeduara të cilat janë duke u matur me koston më të ulët dhe vlerën neto të realizueshme. Matja e vlerës së drejtë përfshin përdorimin e vlerësimeve të pavarura të jashtme të pronës, nga një vlerësues që ka kualifikimet e duhura ligjore profesionale, e cila më pas është shqyrtuar nga Menaxhmenti i Bankës për inputet e rëndësishme jo të dukshme dhe ndonjë rregullim i nevojshëm për shlyerje.

Banka nuk mban pronat e riposeduara në pasqyrën e pozicionit financiar për periudhë më të gjatë se 5 vite. Vlerat e drejta të pasurive të ri poseduara të Bankës janë të kategorizuara në Nivelin 3 të hierarkisë së vlerës së drejtë.

Teknikat e vlerësimit dhe inputet e rëndësishme jo të dukshme

Tabela e mëposhtme tregon teknikën e vlerësimit të përdorur në matjen e vlerës së drejtë si dhe përdorimin e inuteve të rëndësishme të pavëzhgueshme.

Teknikat e vlerësimit	Inpute te rëndësishme te pavëzhgueshme
Referencë në tregun aktual: Modeli i vlerësimit përdor çmimet dhe informacione të tjera të gjeneruara nga transaksionet e tregut duke përfshirë pasuritë identike ose të krahasueshme (të ngjashme), detyrimet, ose një grup të pasurive dhe detyrimeve (p.sh. një biznes)	Çmimet e tregut janë modifikuar për të pasqyruar: • nivelin e transaksioneve të tregut, kur aktiviteti i tregut është i ulët ose çmimi për një pronë të njëjtë është e vështirë për tu marrë; • gjendja specifike e secilës pronë (ndërtim, pozita etj)

c) Përcaktimi i vlerës së drejtë

Përcaktimi i vlerës së drejtë të pasurive dhe detyrimeve financiare për të cilat nuk ka çmim tregu kërkon përdorimin e teknikave të vlerësimit siç përshkruhet në shënimin 3. (f). (vi). Për instrumentet financiare që tregtohen rrallë dhe kanë transparencë të vogël të çmimeve, vlera e drejtë është më pak objektive dhe kërkon nivele të ndryshme gjykimi në varësi të likuiditetit, përqendrimit, pasigurisë së faktorëve të tregut, supozime rreth çmimit dhe rreziqe të tjera që ndikojnë mbi instrumentin specifik. Banka vlerëson vlerën e drejtë duke shfrytëzuar hierarkinë e mëposhtme të metodave:

- **Niveli 1:** Çmim i kuotuar i tregut në tregje aktive për instrumentet identike;
- **Niveli 2:** Metodë vlerësimi bazuar në inute të rëndësishme. Kjo kategori përfshin instrumentet e vlerësuara duke shfrytëzuar: çmimet e tregut për instrumente të ngjashme në tregjet aktive, çmimet e tregut për instrumentet të ngjashme në tregjet më pak aktive apo teknika tjera të vlerësimit në të cilat të gjithë faktorët material në mënyrë direkte apo indirekte janë të vëzhgueshëm nga të dhënat e tregut.
- **Niveli 3:** Metodë vlerësimi bazuar në inute të rëndësishme jo të vëzhgueshme. Kjo kategori përfshin të gjithë instrumentet për të cilat teknikat e vlerësimit përfshijnë faktorë që nuk bazohen në të dhëna të vëzhgueshme dhe faktorët e pavëzhgueshëm kanë një ndikim material në vlerësimin e instrumentit. Kjo kategori përfshin instrumentet që janë vlerësuar në bazë të çmimeve të tregut për instrumente të ngjashme për të cilat rregullime apo gjykime materiale të pavëzhgueshme kërkohen për të reflektuar dallimet në mes të instrumenteve.

Vlerësimi i vlerës së drejtë është shpalosur në shënimin d).

Banka për Biznes Sh.a.**Shënimet e pasqyrave financiare**

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

*(Shumat janë në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)***5. PËRDORIMI I VLERËSIMEVE DHE GJYKIMEVE (VAZHDIM)****d) Paraqitja dhe vlerësimi i vlerës së drejtë**

Vlerësimet e vlerave reale bazohen në instrumente financiare në pasqyrën ekzistuese të pozicionit financiar të Bankës pa u përpjekur për të vlerësuar vlerën e biznesit të pritsëm dhe vlerën e pasurive dhe detyrimeve që nuk konsiderohen instrumenta financiar.

Instrumentet financiare - Hierarkia e vlerës së drejtë

Tabela e mëposhtme përcakton vlerën e drejtë të instrumenteve financiare të matura dhe jo të matura me vlerën e drejtë dhe i analizon ato sipas nivelit të tyre në hierarkinë e vlerës së drejtë, në të cilën është kategorizuar secila matje me vlerën e drejtë.

	2017			2016		
	Vlera kontabël	Vlera e drejtë Niveli 2	Niveli 3	Vlera kontabël	Vlera e drejtë Niveli 2	Niveli 3
Pasuritë financiare të matura me vlerën e drejtë						
Të mbajtura për shitje	17,152	17,181	-	18,267	18,299	-
Pasuritë financiare të matura me vlerë jo të drejtë						
Paraja e gatshme dhe në banka	51,831	-	51,831	39,939	-	39,939
Kreditë dhe paradhëniet për banka	1,450	-	1,450	600	-	600
Kreditë dhe paradhëniet për klientët	131,314	-	129,857	101,885	-	100,754
Pasuritë tjera financiare	143	-	143	237	-	237
Detyrimet financiare të matura me vlerë të drejtë						
Depozitat e klientëve	177,780	-	178,415	140,598	-	141,101
Kreditë e varura	840	-	838	1,845	-	1,839
Huamarrjet	4,143	-	3,531	4,248	-	3,620
Detyrimet tjera financiare	1,673	-	1,673	1,346	-	1,346

Vlerat e drejta për pasuritë dhe detyrimet financiare të mësipërme janë përcaktuar duke shfrytëzuar Nivelin 2 dhe 3 të dhënave të përshkruara më lartë.

Vlerësimet e vlerave reale bazohen në instrumente ekzistuese financiare në pasqyrën e pozicionit financiar të Bankës pa u përpjekur për të vlerësuar vlerën e biznesit të pritsëm dhe vlerën e pasurive dhe detyrimeve që nuk konsiderohen instrumente financiarë.

Llogaritë me bankat

Llogaritë nga bankat e tjera përfshijnë plasmanët ndër-bankare. Përderisa kreditë, avanset dhe depozitat janë afatshkurtër dhe me norma të ndryshueshme, vlera e tyre e drejtë është konsideruar të jetë e barabartë me vlerën e tyre kontabël.

Bonot e thesarit

Bonot e thesarit përfshijnë bono të emetuara nga Qeveria e Kosovës, të cilat janë blerë me qëllim për ti mbajtur deri në maturim. Vlera e drejtë është vlerësuar duke përdorur një model të zbritur të rrjedhës së parasë bazuar në një lakore aktuale të kthimit të përshtatshëm për periudhën e mbetur deri në maturim.

Obligacionet

Obligacionet janë obligacionet e emetuara nga Qeveria e Kosovës, të cilat janë blerë me qëllim për ti mbajtur deri në maturim. Çmimet e kuotuar në tregjet aktive nuk ishin në dispozicion për këto letra me vlerë. Megjithatë, ka pasur informacione të mjaftueshme në dispozicion për të matur vlerën e drejtë të këtyre letrave me vlerë në bazë të inputeve të vëzhgueshme të tregut.

Banka për Biznes Sh.a.**Shënimet e pasqyrave financiare**

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

*(Shumat janë në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)***5. PËRDORIMI I VLERËSIMEVE DHE GJYKIMEVE (VAZHDIM)****d) Paraqitja dhe vlerësimi i vlerës së drejtë (vazhdim)*****Instrumentet financiare - Hierarkia e vlerës së drejtë (vazhdim)******Kreditë dhe paradhëniet për klientët***

Kur është e mundur, vlera e drejtë e kredive dhe paradhënieve është e bazuar në transaksionet e vëzhgueshme të tregut. Kur transaksionet e vëzhgueshme të tregut nuk janë në dispozicion, vlera e drejtë është vlerësuar duke përdorur metodat e vlerësimit, të tilla si teknikat e rrjedhës së parasë të aktualizuar. Teknikat e vlerësimit përfshijnë humbjet e pritshme të kredisë, normat e interesit dhe normat e parapagimit. Për të përmirësuar saktësinë e vlerësimit të kredive tregtare dhe të bizneseve të vogla, kreditë homogjene grupohen në portofol me karakteristika të ngjashme.

Portofolio e kredive të Bankës ka një vlerë të drejtë të vlerësuar të përafërt me vlerën e tij kontabël për shkak të natyrës së tyre afatshkurtër ose të normave të interesit të cilat përafrojnë me normat e tregut. Pjesa më e madhe e portofolit të kredive është subjekt i ndryshimit të çmimeve brenda një viti.

Detyrime ndaj klientëve, huamarrjet dhe kreditë e varura

Vlera e drejtë e borxhit të varur dhe depozitat ndaj klientëve janë vlerësuar duke përdorur teknika të aktualizimit të rrjedhës së parasë, duke zbatuar normat që janë ofruar për depozitat dhe për borxhin e varur me maturitet dhe kushte të ngjashme. Vlera e drejtë e depozitave të pagueshme sipas kërkesës është shuma e pagueshme në datën e raportimit.

6. TË ARDHURAT NETO NGA INTERESI

Të ardhurat neto nga interesi përbëhen si në vijim:

	2017	2016
Të ardhurat nga interesi:		
Kreditë dhe paradhënie për klientët	11,203	9,716
Kreditë dhe paradhënie për bankat	50	7
Investimet e mbajtura deri në maturitet	134	98
	11,387	9,821
Shpenzimet e interesit:		
Depozitat nga klientët	(1,463)	(1,347)
Kreditë e varura	(150)	(203)
Huamarrjet	(128)	(120)
	(1,741)	(1,670)
Të ardhurat neto nga interesi	9,646	8,151

7. TË ARDHURAT NETO NGA TARIFAT DHE KOMISIONET

	2017	2016
Te ardhurat nga tarifat dhe komisionet		
Transfere pagesash dhe transaksione	1,702	1,525
Tarifat e mirëmbajtjes së llogarive	548	433
Tarifa dhe komisionet tjera	59	42
Gjithsej të ardhurat nga tarifat dhe komisionet	2,309	2,000
Shpenzimet për tarifa dhe komisione:		
Tarifat dhe komisionet për llogaritë bankare	(557)	(422)
Tarifat dhe komisionet për shpërndarjen e ndihmave sociale	(49)	(49)
Tarifat dhe komisionet tjera	(47)	(51)
Gjithsej shpenzimet për tarifat dhe komisionet	(653)	(522)
Të ardhurat neto nga tarifat dhe komisionet	(1,656)	1,478

Banka për Biznes Sh.a.**Shënimet e pasqyrave financiare**

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

*(Shumat janë në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)***8. TË ARDHURA TJERA OPERATIVE**

	2017	2016
Të ardhurat nga riposedimi i ndërtesës së Gjakovës	580	-
Fitimi nga shitja e asetëve të riposeduara	168	-
Të ardhura tjera	42	35
Gjithsej	790	35

Ndërtesa e Gjakovës lidhet me një hua që është shlyer disa vite më parë. Procesi i riposedimit nuk u përfundua deri në vitin 2017 dhe ndërtesa u njoh në të ardhura në vitin aktual.

9. SHPENZIMET TJERA OPERATIVE

	2017	2016
Shpenzimet e personelit (shih më poshtë)	3,472	2,717
Qiraja	641	623
Zhvlerësimi dhe Amortizimi	484	398
Sigurimi dhe siguria fizike	306	290
Shërbimet komunale dhe karburanti	168	168
Riparimet dhe mirëmbajtja	160	148
Komunikimi	235	137
Konsulenca	167	74
Shpenzimet ligjore	141	196
Shpenzimet e procesimit të kartelave	252	190
Shpenzimet e marketingut dhe reklamimit	251	161
Shpenzimet e pastrimit	48	42
Materialet për zyre	58	54
Shpenzimet e anëtarëve të bordit	40	42
Udhëtimi	21	15
Shpenzime tjera	441	367
Gjithsej	6,885	5,622

Numri i të punësuarve më 31 dhjetor 2017 është 340 (31 dhjetor, 2016: 327).

Shpenzimet e personelit përbëhen si më poshtë:

	2017	2016
Paga	2,741	2,323
Kontribute pensionale	141	119
Përfitimet tjera	545	250
Kompensime tjera	45	25
Gjithsej	3,472	2,717

Banka për Biznes Sh.a.**Shënimet e pasqyrave financiare**

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

*(Shumat janë në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)***10. SHPENZIMET E TATIMIT NË FITIM**

Ngarkesa e tatimit në fitim dallon nga shuma teorike që do të vinte nëse do të shfrytëzohej norma mesatare e ponderuar e tatimit e aplikueshme në fitimet e bankës si më poshtë:

	Norma efektive e tatimit	2017	Norma efektive e tatimit	2016
Tatimi para tatimit		6,165		4,315
Tatimi i kalkuluar në 10%	10%	617	10%	432
Rregullime për shkak të diferencës në provizionet e kredive bazuar në rregullat e BQK	-	-	-	-
Efekti i tatimit nga kreditë jashtëbilancore	0.78%	48	-	-
Efekti i tatimit nga shpenzimet e pazbritshme	0.70%	43	0.05%	1
Efekti i tatimit në interesin aktual në depozitat	0.15%	9	(1.00%)	20
Rregullimet në të ardhura tjera	1.35%	(83)	-	-
Shfrytëzimi i humbjeve sipas tatimeve të bartura përpara	-	-	(9.05%)	(88)
Shpenzimi i tatimit në fitim	10.3%	634	8.5%	365

Tatimi i shtyrë është llogaritur me normën prej 10%. Pasuritë nga të hyrat e shtyra tatimore janë njohur vetëm deri në masën që realizimi i përfitimit tatimor është i mundshëm. Me 31 dhjetor 2017 neto pasuritë tatimore të shtyra në shumën prej zero mijë Euro (2016: zero mijë Euro) nuk janë njohur si diferencë neto e përkohshme për shkak të pasigurisë që fitimet e tatueshme të mjaftueshëm do të jene të vlefshme për të lejuar që të shfrytëzohen në dobi të kësaj pasurie tatimore të shtyrë.

	2017	2016
Detyrimi në fillim	75	-
Shtesat gjatë vitit	634	365
Pagesat gjatë vitit	(565)	(290)
Detyrimi në fund	144	75

Në pajtim me ligjin e tatimeve në Kosovë humbjet tatimore mund të barten deri në 6 vite.

Tatimi në fitim vlerësohet me normën 10% (2016:10%) nga të ardhurat e tatueshme: tabela e në vijim paraqet harmonizimin ndërmjet fitimit kontabël dhe tatimit në fitim:

	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017
Humbjet sipas tatimeve të gjatë vitit	1,160	2,232	(87)	(789)	(1,814)	(869)	-
Humbjet sipas tatimeve të bartura përpara	1,327	3,559	3,472	2,683	869	-	-

11. PARAJA E GATSHME DHE NË BANKA

	2017	2016
Paratë e gatshme	9,981	5,743
Paraja në banka	7,852	6,948
Gjithsej	17,833	12,691

Paratë e gatshme dhe ekuivalentet e saj përbëhen si në vijim:

	2017	2016
Paraja e gatshme dhe në banka	17,833	12,691
Gjendja e pakufizuar në BQK (shënimi 12)	19,031	14,955
Gjithsej	36,864	27,646

Banka për Biznes Sh.a.**Shënimet e pasqyrave financiare**

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

*(Shumat janë në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)***12. GJENDJA ME BANKËN QENDRORE TË KOSOVËS**

	2017	2016
Rezerva e detyrueshme	14,967	12,293
Llogaritë rrjedhëse	19,031	14,955
Gjithsej	33,998	27,248

Në përputhje me kërkesat e BQK-së në lidhje me rezervën e depozitave për qëllime të likuiditetit, Banka duhet të mbajë një minimum prej 10% të depozitave të klientëve me maturitet deri në një vit, si rezerva të detyrueshme. Rezervat e detyrueshme duhet të përfaqësojnë instrumente me likuiditet të lartë, duke përfshirë para të gatshme, llogaritë në BQK ose në bankat e tjera në Kosovë, si dhe shumat e mbajtura në BQK nuk duhet të jenë më pak se gjysma e totalit të rezervës së detyrueshme. Pasuritë me të cilat Banka mund të plotësojë kërkesat e likuiditetit janë depozitat në Euro me BQK-në dhe 50% ekuivalentit në Euro të parave të gatshme, në valuta lehtësisht të konvertueshme. Depozitat me BQK-në nuk duhet të jenë më pak se 5 % e bazës së depozitave të aplikueshme.

13. KREDITË DHE PARADHËNIET PËR BANKAT

	2017	2016
Depozitat me afat		
Zirat Bankasi	1,000	-
IS Bankasi	350	-
	1,350	-
<i>Llogaritë e bllokuara</i>		
Raiffeisen Bank International	100	600
	100	600
Gjithsej	1,450	600

Kreditë dhe paradhëniat për banka përfshijnë llogaritë e bllokuara në emër të garancioneve të klientëve.

14. LETRAT ME VLERË TË MBAJTURA PËR SHITJE

	2017	2016
Bono thesari	5,224	10,720
Obligacione qeveritare	11,928	7,547
Gjithsej	17,152	18,267

Gjatë vitit 2017, Banka ka shitur afërsisht 19 instrumente financiare. Instrumentet financiare janë shitur me çmim më të lartë krahasuar me çmimin blerës. Blerësi i vetëm i instrumenteve financiare ishte Banka Qendrore e Kosovës. Fitimi është njohur në fitim dhe humbje në shumë prej 1,065 mijë Euro (2016: 1,878 mijë Euro).

Banka për Biznes Sh.a.**Shënimet e pasqyrave financiare**

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

*(Shumat janë në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)***15. KREDITË DHE PARADHËNIE PËR KLIENTËT**

	2017	2016
Kreditë dhe paradhëniet për klientët	136,789	107,905
Interesi akrual	658	561
Tarifat e shtyra të disbursimit	(902)	(649)
Gjithsej	136,545	107,817
Provizionet për humbjet e kredive	(5,231)	(5,932)
Kreditë dhe paradhëniet neto të klientëve	131,314	101,885

Lëvizjet në provizionet e humbjeve të kredive si në vijim:

	2017	2016
Më 1 janar	5,932	5,465
Provizioni për humbjet nga kreditë	515	1,045
Kreditë jashtëbilancore	(1,216)	(578)
Më 31 dhjetor	5,231	5,932

Banka menaxhon ekspozimet kundrejt një pale me qëllim që të jetë në pajtim me rregullat dhe rregulloret e Bankës Qendrore që kërkojnë që ekspozimi kundrejt një pale të vetme të mos kalojë 15% të kapitalit të klasit të parë (apo 19,628 mijë Euro).

Me 31 dhjetor 2017 dhe 2016 nuk ka ndonjë ekspozim kundrejt një pale të vetme që tejkalon limitin prej 15%. Për më tepër ekspozimi kumulativ i top 10 klientëve të bankës është 9,324 mijë Euro (2016: 9,757 mijë Euro ose 9%).

Barazimi për lejimet për humbjet nga kreditë dhe paradhëniet sipas klasave është si në vijim:

	2017			2016		
	Korporata	Individual	Gjithsej	Korporata	Individual	Gjithsej
Më 1 janar	5,189	743	5,932	4,895	570	5,465
Shtesa për vitin	609	(94)	515	872	173	1,045
Shuma e shlyer	(897)	(319)	(1,216)	(578)	-	(578)
Më 31 dhjetor	4,901	330	5,231	5,189	743	5,932

16. PASURITË TJERA FINANCIARE

	2017	2016
Kërkesa nga klientët	14	14
Të hyra akruale nga shërbimet bankare	40	84
Të hyrat akruale për tarifa dhe komisione	54	55
Të arkëtueshme nga garancionet	-	70
Të arkëtueshme tjera	35	14
Gjithsej	143	237

17. PASURITË TJERA

	2017	2016
Shpenzime të parapaguara	815	141
Gjithsej	815	141

Banka për Biznes Sh.a.**Shënimet e pasqyrave financiare**

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

*(Shumat janë në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)***18. PASURITË E RI POSEDUARA**

Pasuritë e ri poseduara janë pasuritë e përvetësuara përmes ushtrimit të së drejtës mbi hipotekat për mbulimin e kredive dhe paradhënies të klientëve. Banka tenton dhe ndërmerr hapa që ti shesë këto pasuri për një periudhë afatshkurtër të arsyeshme.

	2017	2016
Pasuritë e patundshme banesore	558	572
Pasuritë e patundshme komerciale	1,008	1,688
Gjithsej	1,566	2,260
Minus: Provizioni për zhvlerësim	(1,411)	(1,362)
Vlera neto kontabël	155	898

Vlera e drejtë e këtyre pasurive është përcaktuar duke iu referuar vlerave të tregut nga ana e vlerësuesit të jashtëm të pavarur. Vlerat janë ulur në varësi të vendndodhjes së tyre, mirëmbajtjes dhe kushteve dhe rrethanave që pasqyrojnë vonesat e mundshme në shitjen e tyre dhe gjatësinë e kohës për mbajtjen e pasurive. Lëvizjet në zhvlerësimin e pasurive janë si në vijim:

	2017	2016
Më 1 janar	1,362	833
Zhvlerësim gjatë vitit	197	529
Kthimet nga pakësimet	(148)	-
Më 31 dhjetor	1,411	1,362

19. PASURITË E PAPREKSHME**Programe kompjuterike****Kosto**

Gjendja më 1 janar 2016	894
Shtesat gjatë vitit	156
Gjendja më 31 dhjetor 2016	1,050
Shtesat gjatë vitit	245
Gjendja më 31 dhjetor 2017	1,295
Amortizimi i akumuluar	-
Gjendja më 1 janar 2016	747
Shpenzimi për vitin	77
Gjendja më 31 dhjetor 2016	824
Shpenzimi për vitin	133
Gjendja më 31 dhjetor 2017	957
Vlera kontabël	-
Gjendja më 31 dhjetor 2016	226
Gjendja më 31 dhjetor 2017	338

Banka për Biznes Sh.a.**Shënimet e pasqyrave financiare**

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

*(Shumat janë në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)***20. PRONA DHE PAJISJET**

Kosto	Përmirësimet në objektet e Mablet, dhe Kompjuterët dhe pajisjet Automjetet Gjithsej					
	Ndërtesat	me qira	pajisjet	dhe pajisjet		
Më 1 janar 2016	109	774	545	1,180	597	3,205
Shtesat gjatë vitit	-	71	19	113	73	276
Heqjet gjatë vitit	(13)	(18)	(79)	(13)	(17)	(140)
Më 31 dhjetor 2016	96	827	485	1280	653	3,341
Shtesat gjatë vitit	587	173	62	186	97	1,105
Shlyerjet gjatë vitit	-	(53)	(29)	(26)	-	(109)
Më 31 dhjetor 2017	683	947	517	1,440	750	4,337
Zhvlerësimi i akumuluar						
Më 1 janar 2016	15	461	441	873	374	2,164
Ngarkesa për vitin	2	90	42	94	93	321
Shlyerjet gjatë vitit	(13)	(16)	(21)	(24)	(50)	(124)
Më 31 dhjetor 2016	4	535	462	943	417	2,361
Ngarkesa për vitin	3	119	51	122	56	351
Shlyerjet gjatë vitit	-	(46)	(29)	(25)	-	(100)
Më 31 dhjetor 2017	7	608	484	1,040	473	2,612
Vlera kontabël						
Më 31 dhjetor 2016	92	292	23	337	236	980
Më 31 dhjetor 2017	676	339	33	400	277	1,725

Më 31 dhjetor 2017 dhe 2016, Banka nuk ka ndonjë pronë të lënë si peng.

Në kuadër të pronave dhe pajisjeve me 31 dhjetor 2017 është futur edhe ndërtesa me vlerë 676 mijë Euro (2016: 92 mijë Euro) i cili është kolateral i ri poseduar dhe menaxhmenti ka vendosur ta shfrytëzojë për aktivitetet e përditshme të Bankës.

Më poshtë janë pjesë të Pronës dhe Pajisjeve që janë zhvlerësuar plotësisht, por janë akoma në përdorim më 31 dhjetor 2017:

Kategoria	Kosto	Zhvlerësimi akumuluar	Vlera Neto
Ndërtesa	9	9	-
Përmirësime në objekte me qira	418	418	-
Mobilje, orendi dhe pajisje	511	511	-
Kompjuterë dhe pajisje të ngjashme	674	674	-
Vetura	237	237	-
Softuerë	771	771	-
Gjithsej	2,620	2,620	-

Banka për Biznes Sh.a.**Shënimet e pasqyrave financiare**

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

*(Shumat janë në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)***21. DEPOZITAT NGA KLIENTËT**

	2017	2016
Llogaritë rrjedhëse	70,685	60,214
Në Euro	67,132	58,565
Në valuta të huaja	3,553	1,649
Depozitat e afatizuara	107,095	80,384
Në Euro	106,368	78,388
Në valuta të huaja	727	1,996
Gjithsej	177,780	140,598

22. KREDITË E VARURA DHE HUAMARRJET

	2017	2016
Kreditë e varura		
BERZH	-	1,005
<i>Individët:</i>		
Valon Budima	420	420
Armend Skeja	420	420
Gjithsej	840	1,845

Gjatë vitit 2017, Banka ka parapaguar plotësisht borxhin e varur në BERZH në vlerë prej 1,000 mijë Euro së bashku me interesin në shumën prej 25 mijë Euro dhe pagesën e provizionit të parapagimeve prej 20 mijë Euro. Parapagimi bëhet pas miratimit nga BQK-ja.

Kreditë e varura janë dhënë nga palët e mësipërme për ti lejuar Bankës të mbajë nivelet minimale të kapitalit rregullator.

Borxhet e varura nga individët ripaguhen më 26 dhjetor 2023. Kreditë e varura nga individët nuk kanë kushte të veçanta të bashkangjitura me marrëveshje.

	2017	2016
Huamarrjet		
Kredia nga FEEJ	3,128	3,240
Kredia nga BERZH	1,015	1,008
Gjithsej	4,143	4,248

Gjatë vitit 2016, Banka ka hyrë në një marrëveshje huamarrëse me BERZH (Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim) për një total prej 1,000 mijë Euro. Qëllimi është për të mbështetur individët privat dhe portofolion e kredive të NVM-ve në lidhje me programin e efikasitetit të energjisë. Huamarrja bartë një normë interesi vjetor prej 3.6%, dhe është e pagueshme brenda pesë viteve. Interesi është i pagueshëm në baza tremujore.

Gjatë vitit 2015, Banka ka hyrë në një marrëveshje huamarrëse me FEEJ (Fondi Evropian për Evropën Juglindore) për një total prej 1,000 mijë Euro. Qëllimi është për të mbështetur individët privat dhe portofolion e kredive të NVM-ve. Huamarrja bartë një normë interesi vjetor prej 3.4%, dhe është e pagueshme brenda tri viteve. Interesi është i pagueshëm në baza tremujore.

22.1 Ndryshimet në borxhe si rezultat i aktiviteteve investuese janë si në vijim:

	1 janar 2017	Hyrjet e parasë	Daljet e parasë	Interesi akruar	Dividenda e deklaruar	31 dhjetor 2017
Borxhi i ndërvarur	1,845	-	(1,005)	-	-	840
Huamarrjet	4,248	1,500	(1,595)	(10)	-	4,143
Dividendat e pagueshme	-	-	(285)	-	285	-
Gjithsej detyrimet nga aktivitetet financuese	6,093	1,500	(2,885)	(10)	285	4,983

Banka për Biznes Sh.a.**Shënimet e pasqyrave financiare**

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

*(Shumat janë në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)***23. DETYRIMET DHE PROVIZIONET TJERA**

Detyrimet tjera më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 janë të përbëra si në vijim:

	2017	2016
Pagesat për palët e treta	712	593
Provizionet për letër garanci të lëshuara nga Banka	19	-
Të Pagueshme në emër të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale	630	450
Të Pagueshme në emër të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave	121	78
Detyrime ndaj furnitorëve	191	225
Gjithsej detyrime tjera	1,673	1,346
Provizione tjera	506	404
Gjithsej	2,179	1,750

Banka vepron si agjent për transaksionet e kryera në emër të institucioneve qeveritare me palët e treta. Kjo përfshin pagesat në emër të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave.

Provizionet e tjera përfaqësojnë një provizion të krijuar për çështje ligjore kundrejt palëve të treta. Bazuar në politikat dhe procedurat e bankës, Banka përcakton në secilin tremujore rezervat aktuale përmes rivlerësimit të secilës çështje ligjore individualisht.

Në vijim është paraqitur lëvizja në provizione më 31 dhjetor:

	2017	2016
Në fillim	404	642
Shtesat gjatë vitit	123	622
Të shfrytëzuara gjatë vitit	(21)	(860)
Në fund	506	404

Banka për Biznes Sh.a.**Shënimet e pasqyrave financiare**

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

*(Shumat janë në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)***24. KAPITALI AKSIONAR DHE REZERVAT*****Kapitali aksionar***

Në pajtim me Ligjin nr. 04/L-093 për “Banka, Institucione Microfinanciare dhe Institucione Financiare Jo-Bankare”, kapitali aksionar minimal për bankat që operojnë në Kosovë duhet të jetë 7 milion Euro.

Më 31 Dhjetor 2017 kapitali aksionar i autorizuar ishte i përbërë nga 28,530 aksione të zakonshme (2016: 28,530 aksione të zakonshme). Aksionet e zakonshme kanë një vlerë nominale prej 394.2 Euro secili. Pronarët e aksioneve të zakonshme kanë të drejtë të marrin dividendë që deklarohen kohë pas kohe dhe kanë të drejtën e një vote për aksion në mbledhjet e Bankës. Të gjitha aksionet renditen në mënyrë të barabartë në lidhje me mjetet e mbetura të Bankës.

Një përmbledhje e strukturës së pronësisë është si vijon:

<i>Emri i aksionarit</i>	2017		2016	
	%	Euro ('000)	%	Euro ('000)
1 Afrim Govori	21.27	2,392	21.27	2,392
2 Rustem Aliaj	17.27	1,942	17.27	1,942
3 Shaqir Palushi	11.81	1,328	9.91	1,115
4 EBRD	10.00	1,125	10.00	1,125
5 Mejdi Rexhepi	9.35	1,052	9.35	1,052
6 Moneta sh.p.k	7.15	804	5.35	601
7 Nazmi Viça	6.89	775	6.89	775
8 Kareman Limani	4.85	545	4.85	545
9 Banka di Cividale	4.62	520	4.62	520
10 Ahmet Arifi	2.39	269	2.39	269
11 Ismet Sylejmani	1.90	214	1.90	214
12 Naser Aliu	0.50	57	0.62	70
13 Besnik Vrella	0.50	57	0.62	70
14 Agim Bilalli	0.50	57	0.62	70
15 Luani Limited	0.44	49	0.44	49
16 Sokol Krasniqi	0.38	42	0.38	42
17 Flamur Bryma	0.09	10	0.09	10
18 Naim Abazi	0.09	9	0.44	50
19 Rasim Gashi	-	-	1.54	173
20 Riza Mikullovc	-	-	1.45	163
Total	100.00	11,247	100.00	11,247

Banka për Biznes Sh.a.**Shënimet e pasqyrave financiare**

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

*(Shumat janë në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)***25. ZOTIMET DHE KONTIGJENCAT**

Banka lëshon garancione për klientët e saj. Këto instrumente mbartin një risk kreditimi të ngjashëm me ato të kredive të dhëna. Garancionet e lëshuara në favor të klientëve janë siguruar me kolateral në para, dhe kolateral jo në para (pasuri të paluajtshme dhe kolateral të luajtshëm).

Garancionet e lëshuara klientëve	2017	2016
Të siguruar me depozita kesh	591	828
Të siguruar me kolateral (patundshmëri dhe kolateral i luajtshëm)	713	604
Të pasiguruar	-	794
Minus: Provizionet e njohura si detyrime	(29)	(58)
Gjithsej	1,275	2,168

Zotimet përfaqësojnë balancat e pa tërhequra të kredive, overdrafteve dhe limitet e kartave të kreditit të lëshuara për klientët.

Zotimet për kredi	2017	2016
Kreditë e aprovuara por të padisbursuara	51	420
Limitet e pashfrytëzuara të overdrafteve	5,395	4,779
Kartat e kreditit të pashfrytëzuara	453	416
Gjithsej	5,899	5,615

Ligjore

Banka përfshihet në procedura të zakonshme ligjore në rrjedhën normale të biznesit më 31 dhjetor 2017 dhe 2016. Mendimi i menaxhmentit është se rezultati përfundimtar i këtyre padive nuk do të ketë një efekt material në rezultatet e Bankës, përveç provizioneve të cilat janë njohur në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse.

Zotimet e qirasë

Banka ka zotime për qira të cilat janë të detyrueshme, e që përbëhen si në vijim:

	2017	2016
Jo më vonë se 1 vit	138	510
Më shume se një vit dhe jo më shumë se 5 vite	504	113
Gjithsej	642	623

Banka për Biznes Sh.a.

Shënimet e pasqyrave financiare

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Shumat janë në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

26. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR

a) Hyrje dhe përmbledhje

Banka është e ekspozuar në rreziqet e mëposhtme nga përdorimi i pasurive financiare:

- risku i kreditimit
- risku i tregut
- risku i likuiditetit

Ky shënim prezanton informata për ekspozimin e bankës ndaj secilit nga rreziqet e përmendura më lartë, objektivin e Bankës, politikat dhe procedurat për matjen dhe menaxhimin e riskut dhe menaxhimin e kapitalit të bankës.

Korniza për menaxhimin e riskut

Bordi i drejtorëve ("Bordi") ka përgjegjësi për themelimin dhe mbikëqyrjen e kuadrit për menaxhimin e riskut të Bankës. Bordi ka themeluar Komitetin e Auditimit, dhe Komitetin e Riskut, të cilët janë përgjegjës për zhvillimin dhe monitorimin e politikave të bankës mbi menaxhimin e riskut në fushat e tyre specifike.

Politikat e Bankës për menaxhimin e riskut janë themeluar për të identifikuar dhe analizuar rreziqet me të cilat ballafaqohet Banka, për të vendosur kufizimet e duhura të riskut dhe kontrollit si dhe të monitorojnë riskun dhe respektojnë limitet. Politikat dhe sistemet për menaxhimin e riskut rishikohen rregullisht për të pasqyruar ndryshimet në kushtet e tregut, produktet dhe shërbimet e ofruara.

Banka, përmes trajnimeve, procedurave dhe politikave për menaxhim, synon të zhvillojë një ambient kontrollues konstruktiv, në të cilin të gjithë punonjësit i kuptojnë rolet dhe detyrimet e tyre. Këshilli i Auditimit të Bankës është përgjegjës për monitorimin e pajtueshmërisë me politikat dhe procedurat për menaxhimin e riskut të Bankës dhe për të vlerësuar përshtatshmërinë e kornizës për menaxhimin e riskut në raport me rreziqet me të cilat përballet Banka. Këshilli i Auditimit të Bankës në këto funksione ndihmohet nga Departamenti për Auditimin e Brendshëm. Auditimi i Brendshëm kryen rishikimet e rregullta dhe Ad-hoc të kontrollit dhe procedurave për menaxhim të riskut, rezultati i të cilave raportohet tek Këshilli i Auditimit.

Banka operon në kushtet e një krize globale financiare dhe ekonomike dinamike në zhvillim e sipër. Zgjerimi i saj mund të rezultojë në implikime negative në pozicionin financiar të Bankës. Menaxhmenti i Bankës monitoron çdo ditë pozicionin e pasurive dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve, si edhe të zhvillimit të tregjeve financiare ndërkombëtare. Bazuar në këtë, menaxhmenti analizon përfitueshmërinë, likuiditetin dhe koston e fondeve dhe implementon masa të përshtatshme në lidhje me kredi, tregun (kryesisht normën e interesit) dhe riskun e likuiditetit, duke kufizuar kështu efektet e mundshme negative nga kriza globale financiare dhe ekonomike. Në këtë mënyrë Banka i përgjigjet sfidave të tregut duke mbajtur një kapital dhe pozicion likuiditeti të mjaftueshëm.

b) Risku kreditor

Risku kreditor është risku i humbjeve financiare për Bankën nëse një klient apo një palë tjetër e lidhur për një instrument financiar dështon të përmbushë detyrimet kontraktuale, që vijnë nga kreditë dhe paradhëniet e Bankës për klientët dhe për bankat e tjera. Me qëllim të raportimit të menaxhimit të riskut, Banka merr parasysh dhe konsolidon të gjitha elementet e ekspozimit ndaj riskut kreditor (të tilla si risku standard i huamarrësit individual, risku shtetëror dhe sektorial).

Banka për Biznes Sh.a.

Shënimet e pasqyrave financiare

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Shumat janë në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

26. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

b) Risku kreditor (vazhdim)

Menaxhimi i riskut kreditor

Bordi i Drejtorëve e ka deleguar përgjegjësinë për menaxhimin e riskut kreditor te Komiteti i Riskut që aprovon të gjitha ekspozimet kreditore për këto kategori: kredi biznesi SME dhe kredi personale PI deri në 50 mijë Euro, të cilat duhet të aprovohen nga Departamenti i Riskut.

Ekspozimet kreditore më të mëdha se 50 mijë Euro dhe më pak se 10% e kapitalit të klasit të parë të Bankës aprovohen nga Departamenti i Riskut / Komiteti i Kredive, ndërsa ekspozimet mbi 10% të kapitalit të bankës duhet të aprovohen nga Bordi i Drejtorëve sipas politikave të Riskut Kreditor.

Bazuar në kërkesën e autoritetit rregullator, gjatë vitit 2017, Banka ka bërë ndryshime në përgjegjësitë e menaxhimit të riskut dhe veçanërisht në menaxhimin e riskut kreditor. Që nga Marsi i vitit 2017, sipas Rregullores mbi Qeverisjen Korporative të Bankave, është prezantuar struktura e re organizative ku Departamenti i Riskut është ndarë në dy departamente të veçanta, Departamentin e Menaxhimit të Riskut dhe Departamentin e Riskut Kreditor.

Departamenti i Menaxhimit të Riskut është përgjegjës për përpilimin apo rishikimin e politikave dhe procedurave që lidhen me riskun kreditor dhe njëkohësisht është përgjegjës për procesin e vlerësimit të pronave të paluajtshme, procesin e monitorimeve të kredive, klasifikimin e kredive dhe peshimin e mjeteve të riskut sipas Rregullores së Adekuatshmërisë së Kapitalit si dhe identifikimin e riskut kreditor që rrjedhë nga produktet/proceset e reja që involvojnë kreditimin. Departamenti i Menaxhimit të Riskut është i organizuar në tre sektorë duke përfshirë Sektorin e Riskut Kreditor, Sektorin e Riskut të Tregut dhe Likuiditetit, si dhe Sektorin e Riskut Operacional.

Departamenti i Riskut Kreditor është përgjegjës për menaxhimin e procesit të vlerësimit të aftësisë kredimarrëse dhe kapacitetit kreditor, vlerësimin e mjaftueshmërisë së kolateralit, procesin e vendimarrjes, montorimin/menaxhimin e kredive problematike dhe jo-performuese, duke i përfshirë edhe kreditë në humbje dhe ato jashtëbilancore që menaxhohen nga kompanitë e jashtme (outsourcing), si dhe identifikimin e riskut kreditor që rrjedhë nga produktet/proceset e reja që involvojnë kreditimin. Departamenti i Riskut Kreditor përfshin sektorin e huadhënies dhe sektorin e menaxhimit të vonesave (collection).

Banka ka ndjekur strategjinë e përcaktuar lidhur me diversifikimin e mëtejshëm të kredive dhe rritjen e portfolios kreditore sipas segmenteve të përcaktuara të kredive, më saktësisht në segmentet e kredive individuale – PI, segmentin e kredive MIKRO dhe AGRO dhe segmentin e kredive SME. Gjatë vitit 2017 Banka ka bërë një rritje të konsiderueshme të portfolios kreditore edhe sipas volumit edhe sipas numrit, dhe rritja kryesisht ka ardhur nga segmentet e synuara të kredive, respektivisht në segmentet e kredive PI, MIKRO dhe AGRO. Për të mbështetur këtë strategji të rritjes në kredi të vogla, Banka është dashur të rris numrin e stafit posaqërisht në nivel të degës, me ç'rast ka bërë rekrutimin e shumë analistëve të kredive me përvojë kryesisht nga Bankat më të mëdha që operojnë në vend.

Segmenti i portfolios së kredive bazohet në llojin dhe madhësinë e subjektit (huamarrësit), dhe në përgjithësi grupohet në klientët Retail dhe Biznes.

Klientët Retail ose Individual Privat (PI) dhe në këtë grup futen të gjitha llojet e klientëve që kanë burim kryesor të hyrat nga pagat, qiratë stabile, pensione, honorare dhe të hyra tjera të verifikueshme.

Klientët e biznesit ndahen në tre segmente kryesore; MICRO, SME dhe Korporata. Ekziston edhe një nënkategori e klientëve të agrobiznesit të grupuar si klientë AGRO, të cilët shpërndahen sipas procedurave të ndarjes ndërmjet sektorëve kryesorë në MICRO AGRO dhe SME AGRO.

Klientët e biznesit konsiderohen të gjithë klientët të cilët kanë burimin kryesor të të ardhurave nga veprimtaria e biznesit. Segregimi ndërmjet segmenteve të biznesit bazohet në qarkullimin vjetor. Të gjithë klientët e biznesit që kanë qarkullim vjetor deri në 300 mijë Euro konsiderohen si klientë MIKRO. Të gjithë klientët e biznesit që kanë qarkullim vjetor prej 301 mijë Euro deri në 2 milion Euro konsiderohen klientë të SME, ndërsa të gjithë klientët e biznesit që kanë qarkullim vjetor mbi 2 milion Euro konsiderohen si klientë Korporatë.

Banka për Biznes Sh.a.

Shënimet e pasqyrave financiare

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Shumat janë në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

26. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

b) Risku kreditor (vazhdim)

Menaxhimi i riskut kreditor (vazhdim)

Lidhur me kërkesat rregullative për raportimin sipas IFRS 9, Banka ka filluar projektin e implementimit dhe është në proces. Gjatë vitit 2017, Banka ka rekrutuar konsulent për të asistuar në krijimin e metodologjisë dhe implementimin e softuerit. Banka është në proces të zhvillimit të modelit dhe drafti i parë me metodologji pritet të finalizohet në kuartalin e parë të vitit 2018.

Në funksion të strategjisë së bankës për rritjen e portfolios dhe biznesit te saj në segmentet Mikro dhe NVM, Banka ka lidhur marrëveshje me Fondin Kosovar për Garanci Kreditore, për sigurimin e pjesëshëm të kredive ndaj klientëve NMVM (Ndërmarrje Mikro, të Vogla dhe të Mesme) që i disburson BPB. Ky fond apo kjo garanci kreditore jepet për të lehtësuar rritjen e kredithënies nga Banka për NMVM në Kosovë, duke përmirësuar kushtet dhe duke rritur volumin e kredive për NMVM-te.

Në muajin Gusht 2016 Banka ka lidhur marrëveshjen e parë në vlerë prej 1.5 milion Euro me FKGK. Duke marrë përbazë rritjen e vazhdueshme ky fond është përmirësuar në plotësi dhe në Qershor 2017 është lidhur marrëveshje e re për 1.5 milion Euro garanci shtesë nga ky fond, duke arritur vlerën e garantuar nga fondi në 3 milion Euro.

Gjatë vitit 2017, Banka ka vazhduar relacionet me Institucione Financiare Ndërkombëtare (BERZH, FEEJ, IFC dhe Blue Orchard), ku ka marrë edhe një linjë kreditore nga EFSE në shumë prej 1.5 milion Euro. Gjatë vitit 2017, Banka ka realizuar edhe një Asistence Teknike nga FEEJ e cila ka qenë e destinuar kryesisht për Departamentin e Menaxhimit të Riskut. Përmes kësaj asistence, është bërë rishikimi i të gjitha dokumenteve ekzistuese, janë krijuar disa dokumente të reja për disa fusha të riskut, janë rishikuar dhe avancuar proceset ekzistuese dhe të reja, si dhe janë organizuar trajnime të ndryshme për stafin e riskut dhe biznesit lidhur me procesin e kredithënies, analizave financiare dhe menaxhimin e vonesave.

Banka ka përmirësuar procesin e kreditimit duke zhvilluar një softuer për menaxhimin e aplikacioneve të kredive. Zhvillimi është ndarë në tri faza me qëllim që të mbulojë tërë jetëgjatësinë e kredive nga aplikimi deri në likuidim. Faza ose moduli i parë është zhvilluar dhe gjatë vitit 2017 është funksionalizuar plotësisht. Ky modul ka mundësuar automatizimin dhe digjitalizimin e procesit të huadhënies, i cili ka rritur shpejtësinë e aprovimit dhe në të njëjtën kohë ka rritur cilësinë, sasinë, disponueshmërinë dhe qasjen në informata për klientët. Ky zhvillim ka mundësuar gjithashtu analiza të avansuara shumë-nivelëshe dhe kontroll të plotë të procesit të huadhënies deri në detajin e fundit.

Gjatë vitit 2017, ka filluar edhe faza e dytë e zhvillimit të aplikacionit që ka për objektivi të mbulojë procesin e Monitorimit. Ideja e konceptit është prezantuar dhe ka filluar zhvillimi i aplikacionit. Ky modul mbulon monitorimin e ekspozimeve financiare dhe shërben si një sistem i paralajmërimit të hershëm jo vetëm për të menaxhuar dhe mbajtur klientët e kredituar, por edhe për të parandaluar dhe parashikuar përkeqësimin e kushteve financiare të klientëve.

Në muajt në vijim, do të vazhdoj faza e tretë e zhvillimit që ka për objektivi të mbulojë menaxhimin e vonesave dhe arkëtimit të borxheve. Ky modul do të zhvillohet për të mbështetur procesin e menaxhimit dhe arkëtimit të borxheve duke siguruar menaxhim të strukturuar të të dhënave, korrespondencave, alarmeve dhe njoftimeve.

Duke zhvilluar këto tre module kryesore, të gjitha të dhënat në lidhje me huanë dhe klientët e kredisë do të jenë në dispozicion në një vend, të strukturuar dhe të ndërlidhura. Kjo do të mundësojë një qasje holistike në menaxhimin, monitorimin dhe kontrollin e riskut kreditor.

Përveç rritjes së portofolit të kredisë dhe uljes së ekspozimeve të mëdha, Banka ka vazhduar me përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së kredive, në përputhje me trendin e përmirësimit të kredive në nivel të industrisë bankare. Sa i përket treguesit të cilësisë së kredisë - kreditë jo-performuese (NPL), ndonëse në vitin 2016 ajo ishte 4.94%, në vitin 2017 ky tregues u përmirësua në 2.97% dhe ishte më i mirë se mesatarja e industrisë bankare prej 3.10%. Ka pasur gjithashtu përmirësime në kategoritë e tjera të kredive, kreditë problematike (C, D, E) dhe kreditë në vonesë (B, C, D, E).

Banka për Biznes Sh.a.

Shënimet e pasqyrave financiare

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Shumat janë në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

26. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

b) Risku kreditor (vazhdim)

Menaxhimi i riskut kreditor (vazhdim)

Lidhur me përmirësimin e kualitetit të kredive, Banka ka avancuar proceset rreth menaxhimit të vonesave si dhe ka rritur aktivitetet dhe angazhimet, gjë që ka rezultuar që neto provizionet për këtë vit të jenë pothuajse zero. Në këtë drejtim, gjatë vitit 2017 Banka ka rishikuar dhe vazhduar kontratat edhe me dy kompanitë e jashtme për menaxhimin e kredive në vonesë, sidomos për kreditë e vjetra në kategoritë Humbje dhe Write off, kryesisht për shumat deri në 10 mijë Euro.

Banka rishikon të gjitha ekspozimet kreditore në baza të rregullta, përderisa klasifikimi dhe raportimi i kredive bëhet në baza mujore në harmoni me kërkesat e Bankës Qendrore.

Ekspozimet kreditore në shumë mbi 50,000 Euro rishikohen në baza tremujore përderisa po të njejtat monitorohen në baza gjashtëmujore. Ekspozimet nën 50,000 Euro monitorohen në baza vjetore dhe përfshin analizimin e gjendjes financiare të klientëve duke përfshirë edhe analizimin e gjendjes së kolateralit, ekspozimeve në Banka tjera dhe faktorë tjerë që mund të ndikojnë në performancën financiare të huamarrësit.

Gjatë vitit 2017, janë modifikuar dhe përmirësuar format e monitorimit si dhe janë krijuar mekanizma me qëllim të kapjes së informatave relavante në kohë. Në të njëjtën kohë ka vazhduar edhe automatizimi dhe digjitalizimi i monitorimit i cili do të finalizohet në aplikacionin Bleta.

Banka për Biznes Sh.a.**Shënimet e pasqyrave financiare**

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

*(Shumat janë në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)***26. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR (VAZHDIM)****b) Risku kreditor (vazhdim)***Analizat e cilësisë kreditore*

Tabela më poshtë paraqet skenarin më të keq të ekspozimit ndaj riskut kreditor të Bankës më 31 dhjetor 2017 dhe 2016, pa marrë parasysh ndonjë kolateral të mbajtur ose siguri të bashkangjitur. Për pasuritë financiare, ekspozimet e mëposhtme paraqesin vlerat kontabël neto të raportuara në pasqyrën e pozicionit financiar.

	Paraja e gatshme dhe balanca në BQK		Investimet (AFS)		Kreditë dhe paradhëniet klientëve		Pasuritë tjera financiare		Garancionet financiare	
	2017	2016	2017	2016	2017	2016	2017	2016	2017	2016
Ekspozimi maksimal kundrejt riskut kreditor										
Vlera kontabël	51,831	39,939	17,152	18,267	131,314	101,885	143	237	-	-
Shuma e zotuar / garantuar	-	-	-	-	-	-	-	-	7,203	7,841
	51,831	39,939	17,152	18,267	131,314	101,885	143	237	7,203	7,841
<i>Sipas kostos së amortizuar</i>										
Standarde	51,831	39,939	17,152	18,267	127,062	98,285	143	237	-	-
Vrojtuese	-	-	-	-	3,367	1,646	-	-	-	-
Nën standardë	-	-	-	-	2,051	2,550	-	-	-	-
Dyshimta	-	-	-	-	2,389	2,888	-	-	-	-
Humbje	-	-	-	-	1,676	2,448	-	-	-	-
Gjithsej	51,831	39,939	17,152	18,267	136,545	107,817	143	237	-	-
Provizionet për humbjet e kredive (individuale dhe të përgjithshme)	-	-	-	-	(5,231)	(5,932)	-	-	-	-
Vlera neto kontabël	51,831	39,939	17,152	18,267	131,314	101,885	143	237	-	-
Jashtë bilancore: ekspozimi maksimal										
Zotimet për kredi: Risk i ulët – i pranueshëm	-	-	-	-	-	-	-	-	5,899	5,615
Garancionet financiare: Risk i ulët – i pranueshëm	-	-	-	-	-	-	-	-	1,304	2,226
Gjithsej zotimet / garancionet	-	-	-	-	-	-	-	-	7,203	7,841
Provizionet e njohura si detyrime	-	-	-	-	-	-	-	-	(29)	(58)
Gjithsej zotimet	-	-	-	-	-	-	-	-	7,174	7,783

Banka për Biznes Sh.a.**Shënimet e pasqyrave financiare**

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

*(Shumat janë në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)***26. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR (VAZHDIM)****b) Risku kreditor (vazhdim)****Analizat e cilësisë kreditore (vazhdim)**

	2017			2016		
	Individë	Korporata	Gjithsej kreditë	Individë	Korporata	Gjithsej kreditë
Kreditë dhe paradhëniet për klientët						
Shuma bruto	55,571	80,974	136,545	41,609	66,208	107,817
Lejimet për zhvlerësime (individuale dhe të përgjithshme)	(330)	(4,901)	(5,231)	(743)	(5,189)	(5,932)
Vlera neto kontabël	55,241	76,073	131,314	40,866	61,019	101,885
<i>Sipas kostos së amortizuar</i>						
Standarde	55,011	72,051	127,062	40,709	57,576	98,285
Në vëzhgim	164	3,203	3,367	182	1,464	1,646
Nën standarde	110	1,941	2,051	82	2,468	2,550
Dyshimta	129	2,260	2,389	190	2,698	2,888
Humbje	157	1,519	1,676	446	2,002	2,448
Gjithsej bruto	55,571	80,974	136,545	41,609	66,208	107,817
Standarde	(81)	(719)	(800)	(90)	(666)	(756)
Në vëzhgim	(3)	(494)	(497)	(21)	(37)	(58)
Nën standarde	(22)	(446)	(468)	(56)	(643)	(699)
Dyshimta	(67)	(1,723)	(1,790)	(130)	(1,841)	(1,971)
Humbje	(157)	(1,519)	(1,676)	(446)	(2,002)	(2,448)
Gjithsej provizionet	(330)	(4,901)	(5,231)	(743)	(5,189)	(5,932)
<i>Kreditë e ri negociuara</i>						
Vlera bartur	164	6,026	6,190	292	6,127	6,419
<i>Nga të cilat: të rëna në vlerë</i>	26	5,000	5,026	110	4,497	4,607
Lejime për provizionim	(8)	(2,746)	(2,754)	(90)	(3,030)	(3,120)
Vlera e bartur neto	156	3,280	3,436	202	3,097	3,299

Banka për Biznes Sh.a.

Shënimet e pasqyrave financiare

Për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017

(Shumat janë në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

26. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

b) Risku kreditor (vazhdim)

Analiza e cilësisë kreditore (vazhdim)

Kreditë e provizionuara

Kreditë e provizionuara janë kredi për të cilat Banka konstaton se është e mundur që nuk do të mund të mbledhë borxhin kryesor dhe interesin sipas kushteve kontraktuale të kredisë. Këto kredi kategorizohen nga A-ja tek E-ja në sistemin e brendshëm të vlerësimit të kredisë, ku A është Standarde, kurse E është Humbje. Politika e dhënies së këtyre kredisë është detajuar në shënimin 3.(f)(vii).

Vlerësimi individual dhe kolektiv i portofolios së kredisë

Për qëllime të menaxhimit të brendshëm, Banka ndan kreditë në kredi që janë vlerësuar individualisht për provizionim; këto kredi janë klasifikuar si nën-standarde apo më ulët. Të gjitha kreditë e tjera menaxhohen kolektivisht për qëllime të brendshme të provizionimit.

Politika e Bankës kërkon rishikimin e kredisë dhe paradhënieve individuale të klientëve që janë në nivelin mbi 50 mijë Euro (2016: 50 mijë Euro) së paku në baza kuartale kur nevojat individuale e kërkojnë atë.

Kreditë me kushte të ri-negociuara

Kreditë me kushte të ri negociuara janë kredi që janë ristrukturuar për shkak të përkeqësimit të situatës financiare të huamarrësit ku Banka ka bërë koncesione të cilat në rrethana tjera nuk do ti merrte në konsideratë. Pasi të ristrukturohet kredia mbetet në këtë kategori pavarësisht nga ecuria e kënaqshmërisë pas ri-strukturimit.

Politika e jashtëbilancoreve

Banka shlyen një kredi (dhe çfarëdo provizioni për humbje të saj) kur Bordi i Drejtorëve merr vendim në përputhje me rregullat e BQK. Ky përcaktim arrihet pas shqyrtimit të informatave siç janë shfaqja e ndryshimeve të rëndësishme në huamarrësin ashtu që huamarrësi nuk mundet më të paguajë detyrimin apo që të ardhurat nga pengu nuk do të jenë të mjaftueshme për të mbuluar gjithë vlerën e ekspozimit. Gjithsej shuma e jashtëbilancoreve gjatë vitit 2017 është 1,216 mijë Euro (2016: 578 mijë Euro).

Balancat me bankat

Ekspozimet ndërbankare monitorohen nga afër në baza ditore nga ana e menaxhimit të riskut dhe Departamentit të Thesarit. Banka kufizon depozitat e saj dhe transaksionet e tjera bankare në bankat lokale apo ndërkombëtare. Para se të fillojë një marrëdhënie biznesi me një bankë të caktuar, menaxhmenti dhe Departamenti i Riskut kryejnë analiza të gjendjes financiare të institucionit. Performanca financiare e palëve monitorohet vazhdimisht. Për më tepër, të gjitha bankat korrespondente si dhe emetuesit e obligacioneve në të cilat Banka ka ekspozime në investime, monitorohen vazhdimisht për vlerësimet e tyre nga agjencitë ndërkombëtare të vlerësimit si: Standard & Poor (S & P), Fitch dhe Moody.

Në përputhje me rregulloren e re për ekspozimet e mëdha të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, Banka nuk do të ketë asnjë ekspozim agregat të riskut të kreditimit të palëve të lidhura që tejkalon 15% të Kapitalit Rregullator të nivelit të parë. Kreditë dhe paradhëniet për bankat janë dhënë pa kolateral.

Tabela e mëposhtme paraqet llogaritë rrjedhëse të bankës dhe depozitat me afat me bankat korrespondente sipas vlerësimit kreditor:

	2017	2016
A+ deri A-	1,492	2,252
BBB+ deri B-	767	1,868
Të pa rankuara	7,043	3,428
Më 31 dhjetor	9,302	7,548

Banka për Biznes Sh.a.**Shënimet e pasqyrave financiare**

Për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017

*(Shumat janë në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)***26. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR (VAZHDIM)****b) Risku kreditor****Analiza e cilësisë kreditore (vazhdim)***Angazhimet e kreditimit dhe garancionet financiare*

Ekspozimi maksimal nga garancionet financiare përfaqëson shumën maksimale që Banka duhet të paguajë në qoftë se garancia është kërkuar, e cila mund të jetë dukshëm më e madhe se shuma e njohur si detyrim. Ekspozimi maksimal i kredisë për kreditimin e angazhimeve është shuma e zotuar.

Kontrolli i riskut të limiteve dhe politikat e menaxhimit

Banka menaxhon limitet dhe kontrollon përqendrimit e riskut të kredisë kudo që ato janë të identifikuar në mënyrë të veçantë të palët individuale, grupet dhe të njësitë.

Banka strukturon nivelet e riskut të kredisë që ajo ndërmerr duke vendosur kufizime në sasinë e riskut të pranuar në lidhje me një huamarrës të vetëm ose një grupi huamarrësish dhe për segmentet gjeografike dhe industriale. Rreziqet e tilla janë të monitoruara në mënyrë të rregullt dhe në bazë të një rishikimi vjetor ose më të shpeshtë, nëse është e nevojshme.

Ekspozimi ndaj riskut të kredisë menaxhohet përmes një analize të rregullt të aftësisë së huamarrësit potencial për të përmbushur pagesat e interesit dhe principalit dhe duke ndryshuar këto limite kreditimi kur është e nevojshme. Kontrollat e tjera dhe masat zbutëse janë të përshkruara më poshtë.

Kolaterali i mbajtur dhe përmirësime të tjera të kreditit, dhe efekti i tyre financiar

Banka mban kolateral për kreditë dhe paradhëniet për konsumatorët në formën e interesave të hipotekës mbi pronën dhe pasuritë e tjera të luajtshme. Vlerësimet e vlerës së drejtë bazohen në vlerën e kolateralit të vlerësuar në kohën e huamarrjes. Përgjithësisht nuk mbahet kolateral mbi kreditë dhe paradhëniet për bankat.

Një vlerësim i vlerës së drejtë të kolateralit dhe përmirësimeve të tjera të sigurisë ndaj pasurive financiare tregohet mëposhtë:

Kreditë dhe paradhëniet për klient	Ekspozimi maksimal ndaj riskut kreditor		Kolaterali në kesh		Gjithsej kolaterali i përdorur		Ekspozimet neto pa kolateral
	Prona			Paisje	Kolateral i tepërt		
31 dhjetor 2017	136,545	240,564	5,666	57,869	93,114	(197,133)	43,431
31 dhjetor 2016	107,816	231,244	3,905	51,130	77,927	(178,463)	28,889

Banka për Biznes Sh.a.**Shënimet e pasqyrave financiare**

Për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017

*(Shumat janë në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)***26. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR (VAZHDIM)****b) Risku kreditor (vazhdim)****Koncentrimi i riskut kreditor**

Në lidhje me strategjinë e saj për rritjen e portofolit të kredive në segmentet e targetuara të kredive, Banka ka diversifikuar më tej portofolion e kredisë dhe ka reduktuar më tej ekspozimet e mëdha. Në këtë drejtim, gjatë vitit 2017 ka pasur një përmirësim të dukshëm të diversifikimit të madh të ekspozimit, përkatësisht TOP 10 dhe 30 huamarrës. TOP 30 huamarrësit në vitin 2016 ishin 19.23% të totalit të portofolit të kredisë, në vitin 2017 kjo përqindje ka rënë në 13.91%. TOP 10 huamarrësit në vitin 2016 ishin 9.22%, në 2017 kjo përqindje ka rënë në 6.76%. Ndërsa, sa i përket huamarrësit më të madh në raport me kapitalin e klasit të parë, huamarrësi më i madh ishte 8.91% në 2017 (2016, 5.45%).

Banka monitoron përqendrimin e riskut kreditor për sektorë dhe për shpërndarje gjeografike. Një analizë e përqendrimit të riskut kreditor në datën e raportimit është paraqitur si në vijim:

	Paraja e gatshme dhe balanca me BQK-ne		Kreditë dhe paradhëniet për banka		Investimet e mbajtura për shitje		Kreditë dhe paradhëniet për klientët		Pasuritë tjera financiare		Garancionet financiare	
	2017	2016	2017	2016	2017	2016	2017	2016	2017	2016	2017	2016
Koncentrimi sipas sektorëve												
Korporatë	-	-	-	-	-	-	76,073	61,019	-	-	7,203	7,841
Banka	51,831	39,939	1,450	600	17,152	18,267	-	-	-	-	-	-
Retail	-	-	-	-	-	-	55,241	40,866	143	237	-	-
Gjithsej	51,831	39,939	1,450	600	17,152	18,267	131,314	101,885	143	237	7,203	7,841
Koncentrimi sipas lokacionit												
Vendet e EU	2,158	3,519	100	600	-	-	-	-	-	-	-	-
Republika e Kosovës	49,160	35,426	1,350	-	17,152	18,267	131,314	101,885	143	237	7,203	7,841
Vendet tjera	513	994	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Gjithsej	51,831	39,939	1,450	600	17,152	18,267	131,314	101,885	143	237	7,203	7,841

Banka për Biznes Sh.a.

Shënimet e pasqyrave financiare

Për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017

(Shumat janë në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

26. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

c) Risku i tregut

Risku i tregut është risku që ndryshimet në çmimet e tregut, sikurse janë normat e interesit, çmimi i kapitalit dhe normat e këmbimit të valutave të huaja do të ndikojnë të hyrat e Bankës apo vlerën e instrumenteve financiare. Objektivi i menaxhimit të riskut të tregut është të menaxhoj dhe kontrolloj ekspozimet ndaj riskut të tregut brenda parametrave të pranueshëm, duke optimizuar kthimin nga risku. Tregu përkatës i riskut me të cilin merret banka është risku i valutave të huaja dhe risku i normës së interesit dhe këto rreziqe menaxhohen në përputhje me politikat e tyre përkatëse.

Risku i normës së interesit

Risku i normës së interesit është risku i humbjeve për shkak të luhatjes së normave të interesit në instrumentet financiare dhe kryesisht është si rezultat i mospërputhjeve të maturimit midis pasurive dhe detyrimeve. Rrjedhimisht, kjo mund të rrisë kostot e financimit të bankës në krahasim me kthimin e përfituar nga asetet të cilat mund të mbeten të pandryshuara dhe kështu, potencialisht të zvogëlojnë margjinën e interesit.

Për të parandaluar këtë risk, banka mat dhe monitoron riskun e normës së interesit bazuar në analizën e hendekut të çmimit ndërmjet aseteve dhe detyrimeve në mënyrë që të kufizojë ekspozimin ndaj këtij risku dhe të sigurojë përputhjen me rregulloren e BQK-së mbi riskun e normës së interesit në evidencat kontabël i cili është zbatuar që nga 1 janar 2017. Me qëllim të matjes së riskut të normës së interesit, pasuritë dhe detyrimet e bankës shpërndahen brenda periudhave kohore sipas maturimit të tyre dhe pastaj analizohen hendeku i maturitetit dhe i çmimit. Hendeku i normës së interesit plotësohet duke monitoruar ndjeshmërinë e aseteve dhe detyrimeve financiare të Bankës ndaj skenarëve të ndryshëm standard dhe jo standard të normave të interesit. Këto skenarë synojnë të simulojnë luhatjet e normave të interesit për të matur ndikimin mbi rezultatin financiar dhe kapitalin e bankave. Skenarët standard përfshijnë një zhvendosje paralele 2% në kurbën e të ardhurave siç kërkohet nga rregullorja e BQK-së.

Rezultatet nga këto skenarë raportohen në baza mujore për Komitetin e Menaxhimit të Riskut të Likuiditetit të Bankës ("LRMC") dhe në baza tremujore tek Komiteti i Riskut në nivelin e bordit. Si rezultat, ekspozimi i bankës ndaj riskut të normës së interesit mbetet në përputhje me profilin e riskut të bankës dhe brenda kufijve të brendshëm dhe rregullatorë të përcaktuar nga BQK-ja.

Normat mesatare efektive të kategorive të rëndësishme të pasurive dhe detyrimeve financiare të Bankës më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 janë si në vijim:

Pasuritë	USD		EUR	
	2017	2016	2017	2016
Paraja në banka	0.65%	0.65%	-	-
Kreditë dhe paradhëniet për banka	1.34%	-	0.93%	-
Kreditë për klientët	-	-	8.45%	9.29%
Letrat më vlerë të mbajtura për shitje	-	-	1.69%	1.03%
Investimet e mbajtura deri në maturitet	-	-	-	-
Detyrimet				
Depozitat e klientëve	-	0.04%	1.41%	1.39%
Kreditë e varura	-	-	10.04%	10.04%
Huazimet	-	0.65%	3.50%	3.50%

Banka për Biznes Sh.a.**Shënimet e pasqyrave financiare**

Për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017

*(Shumat janë në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)***26. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR (VAZHDIM)****c) Risku i tregut (vazhdim)**

Një analizë e ndjeshmërisë së Bankës ndaj një rritje apo zbritje në tregun e normave të interesit (duke supozuar jo një lëvizje asimetrike në lakoren e përqindjeve dhe një pozitë financiare stabile) është si vijon:

2017	Skenari deri në 1 vit		Skenari mbi 1 vit	
	Rritje	Ulje	Rritje	Ulje
Efekti i përlogaritur i fitimit (humbjes)	(571)	571	686	(686)

2016	Skenari deri në 1 vit		Skenari mbi 1 vit	
	100 bp Rritje	100 bp Ulje	100 bp Rritje	100 bp Ulje
Efekti i përlogaritur i fitimit (humbjes)	(493)	493	555	(555)

Efekti në të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse	Skenari deri në 1 vit		Skenari mbi 1 vit	
	10 bp Rritje	10 bp Ulje	10 bp Rritje	10 bp Ulje
2017: Përlogaritja e efektit në të gatshme për shitje	(5)	5	(56)	56
2017: Gjithsej efekti në ekuitet	(566)	566	742	(742)

Bazuar në analizat e mësipërme nëse norma e interesit rritet për 10 bp, vlera e drejtë bie për 61 mijë Euro. Efekti i normës së interesit në kapital është i njëjtë me efektin në fitim dhe humbje.

Banka për Biznes Sh.a.**Shënimet e pasqyrave financiare**

Për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017

(Shumat janë në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

26. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR (VAZHDIM)**c) Risku i tregut (vazhdim)**

Tabela në vijim tregon instrumentet financiare që sjellin dhe që nuk sjellin interes sipas datës së çmimit të ri.

31 dhjetor 2017		Deri 1 muaj	1-3 Muaj	3-6 Muaj	6-12 Muaj	mbi 1 Muaj	Gjithsej
Pasuritë							
Paraja e gatshme dhe në banka							
Që nuk bartin interes		13,156	-	-	-	-	13,156
Që bartin interes	<i>Fiks</i>	4,317	-	-	-	-	4,317
Gjendja me BQK-në							
Që nuk bartin interes		33,998	-	-	-	-	33,998
Kreditë dhe paradhëniet bankave							
Që bartin interes	<i>Fiks</i>	-	-	-	1,450	-	1,450
Letrat me vlerë							
Që bartin interes	<i>Fiks</i>	50		340	4,983	11,779	17,152
Kreditë e klientëve							
Që bartin interes	<i>Fiks</i>	5,358	6,459	13,039	24,572	81,886	131,314
Pasuritë tjera financiare							
Që nuk bartin interes		143	-	-	-	-	143
Gjithsej		57,382	6,459	13,379	31,005	93,665	201,890
Detyrimet							
Depozitat e klientëve							
Që bartin interes	<i>Fiks</i>	18,834	4,628	9,110	50,122	23,605	106,299
Që nuk bartin interes		71,481	-	-	-	-	71,481
Kreditë e varura							
Që bartin interes	<i>Fiks</i>	-	-	-	40	800	840
Huamarrjet							
Që bartin interes	<i>Variabël</i>	-	1,114		1,114	1,915	4,143
Detyrimet tjera							
Që nuk bartin interes		1,673	-	-	-	-	1,673
Gjithsej		91,988	5,742	9,110	51,276	26,320	184,436
Hendeku		(34,606)	717	4,269	(20,271)	67,345	17,454
Hendeku kumulativ		(34,606)	(33,889)	(29,620)	(49,891)	17,454	

Banka për Biznes Sh.a.**Shënimet e pasqyrave financiare**

Për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017

(Shumat janë në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

26. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR (VAZHDIM)**c) Risku i tregut (vazhdim)**

31 dhjetor 2016	Deri 1 muaj	1-3 Muaj	3-6 Muaj	6-12 Muaj	mbi 1 Muaj	Gjithsej	
Pasuritë							
Paraja e gatshme dhe ne banka							
Që nuk bartin interes	12,691	-	-	-	-	12,691	
Gjendja me BQK-në							
Që nuk bartin interes	27,248	-	-	-	-	27,248	
Kreditë dhe paradhëniet bankave							
Që bartin interes	<i>Fiks</i>	-	350	-	200	50	600
Letrat me vlerë							
Që sjellin interes	<i>Fiks</i>	-	70	3,743	7,128	7,326	18,267
Kreditë e klientëve							
Që bartin interes	<i>Fiks</i>	4,211	6,586	8,645	17,400	65,043	101,885
Pasuritë tjera financiare							
Që nuk bartin interes		237	-	-	-	-	237
Gjithsej	44,387	7,006	12,388	24,728	72,419	160,928	
Detyrimet							
Depozitat e klientëve							
Që bartin interes	<i>Fiks</i>	16,371	3,424	10,512	37,520	12,557	80,384
Që nuk bartin interes		60,214	-	-	-	-	60,214
Kreditë e varura							
Që bartin interes	<i>Fiks</i>	-	4	41	-	1,800	1,845
Huazimet							
Që bartin interes	<i>Variabël</i>	-	45	48	800	3,355	4,248
Detyrimet tjera							
Që nuk bartin interes		1,346	-	-	-	-	1,346
Gjithsej	77,931	3,473	10,601	38,320	17,712	148,037	
Hendeku	(33,544)	3,533	1,787	(13,592)	54,707	12,891	
Hendeku kumulativ	(33,544)	(30,011)	(28,224)	(41,816)	12,891		

Banka për Biznes Sh.a.**Shënimet e pasqyrave financiare**

Për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017

*(Shumat janë në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)***26. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR (VAZHDIM)****c) Risku i tregut (vazhdim)****Ekspozimi ndaj riskut valutor**

Risku i monedhës është risku i humbjeve të mundshme nga pozicioni i hapur në monedhë të huaj për shkak të luhatjeve në kursin e këmbimit. Banka i ekspozohet riskut valutor përmes transaksioneve në valuta të huaja. Banka sigurohet që ekspozimi neto mbahet në një nivel të pranueshëm duke blerë apo shitur valuta të huaja aty për aty kur është e nevojshme për të zgjidhur bilancet afat-shkurtra. Banka administron dhe monitoron riskun e monedhës kundrejt kufijve të përcaktuar në politikën e tij të riskut dhe në rregulloren e BQK-së për Riskun e Këmbimit të Këmbimit. Ekspozimi ndaj riskut të monedhës diskutohet dhe raportohet në baza mujore për komisionin e likuiditetit dhe të riskut të tregut. Valutat e huaja me të cilat merret Banka janë kryesisht dollari amerikanë (USD), Frangu zviceran (CHF), dhe funta e Britanise së Madhe (GBP). Normat e përdorura për konvertim më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 janë si në vijim:

Valuta	2017	2016
	EUR	EUR
1 USD	0.8338	0.9487
1 CHF	0.8546	0.9312
1 GBP	1.1271	1.1680

Një analizë e sensitivitetit të bankës kundrejt rritjes apo zbritjes në normat e konvertimit me valuta të huaja është si në vijim:

Në mijëra Euro	USD		CHF		GBP	
	2017	2016	2017	2016	2017	2016
Normat e ndjeshmërisë	5%	5%	5%	5%	5%	5%
Fitim apo humbje						
+5% Euro	2.97	10.85	2.02	51.6	0.24	7.3
- 5% Euro	(2.97)	(10.85)	(2.02)	(51.6)	(0.24)	(7.3)

Ekspozimi i bankës kundrejt riskut të valutave të huaja është si vijim:

31 dhjetor 2017	EUR	USD	CHF	GBP	Total
Pasuritë financiare					
Paratë e gatshme dhe në banka	13,451	1,657	2,720	5	17,833
Gjendja me Bankën Qendrore të Kosovës	33,998	-	-	-	33,998
Letrat më vlerë të mbajtura për shitje	17,152	-	-	-	17,152
Kreditë dhe paradhëniet për banka	1,450	-	-	-	1,450
Kreditë dhe paradhëniet për klientë	131,314	-	-	-	131,314
Pasuritë tjera financiare	143	-	-	-	143
Gjithsej pasuritë financiare	197,508	1,657	2,720	5	201,890
Detyrimet financiare					
Depozitat nga klientët	173,502	1,598	2,680	-	177,780
Borxhet e varura	840	-	-	-	840
Huamarrjet	4,143	-	-	-	4,143
Detyrimet tjera financiare	1,673	-	-	-	1,673
Gjithsej detyrimet financiare	180,158	1,598	2,680	-	184,436
Pozita e valutave të huaja neto	17,350	59	40	5	17,454

Banka për Biznes Sh.a.**Shënimet e pasqyrave financiare**

Për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017

*(Shumat janë në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)***26. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR (VAZHDIM)****c) Risku i tregut (vazhdim)****Ekspozimi ndaj riskut valutor(vazhdim)**

31 dhjetor 2016	EUR	USD	CHF	GBP	Gjithsej
<i>Pasuritë financiare</i>					
Paratë e gatshme dhe në banka	7,225	1,785	3,565	116	12,691
Gjendja me Bankën Qendrore të Kosovës	27,248	-	-	-	27,248
Kreditë dhe paradhëniet për banka	600	-	-	-	600
Kreditë dhe paradhëniet për klientë	101,885	-	-	-	101,885
Letrat më vlerë të mbajtura për shitje	18,267	-	-	-	18,267
Pasuritë tjera financiare	237	-	-	-	237
Gjithsej pasuritë financiare	155,462	1,785	3,565	116	160,928
<i>Detyrimet financiare</i>					
Depozitat nga klientët	136,953	1,030	2,592	23	140,598
Kreditë e varura	1,845	-	-	-	1,845
Huamarrjet	4,248	-	-	-	4,248
Detyrimet tjera financiare	1,346	-	-	-	1,346
Gjithsej detyrimet financiare	144,392	1,030	2,592	23	148,037
Pozita e valutave të huaja, neto	11,070	755	973	93	12,891

d) Risku i likuiditetit

Risku i likuiditetit është risku që Banka do të ballafaqohet me vështirësi në përmbushjen e detyrimeve të saj financiare me kohë dhe për të përmbushur kërkesat e papritura për fonde nga depozituesit e saj ose nga kreditorët e tjerë. Për më tepër, risku i likuiditetit përfshin gjithashtu riskun që banka nuk do të jetë në gjendje të financojë rritjen e asetëve.

Qasja e Bankës për administrimin e likuiditetit është qe te siguroje, sa me shume qe është e mundshme, qe gjithmonë te ketë likuiditet te mjaftueshëm për të përmbushur detyrimet me kohe, sipas kushteve normale dhe nen presion, pa pesuar humbje te papranueshme apo pa rrezikuar te dëmtoje reputacionin e Bankës. Për këtë qëllim, në baza ditore, banka monitoron pozicionin e saj të likuiditetit dhe kushtet e tregut. Për më tepër, vazhdimisht vlerëson riskun e likuiditetit duke identifikuar dhe monitoruar ndryshimet në financimin e kërkuar për të përmbushur objektivat e biznesit dhe objektivat e përcaktuara në aspektin e strategjisë së përgjithshme të Bankës. Përveç kësaj, Banka mban një portofol të pasurive likuide si pjesë e strategjisë së saj të menaxhimit të riskut të likuiditetit.

Për të siguruar një menaxhim efektiv të riskut të likuiditetit dhe për të siguruar që nuk ndodhin mangësi të likuiditetit, Banka mban bazën e saj të depozitave të devirsifikuar. Si i tillë, banka synon të mbledhë fonde duke përdorur një gamë të gjerë të instrumenteve siç janë depozitat e klientëve ose financimi nga IFI-të, të cilat do të sigurojnë që baza e financimit të mbetet e qëndrueshme.

Përveç raportimit ditor, banka gjithashtu monitoron riskun e likuiditetit në baza mujore. Ky monitorim përfshin pozicionin e likuiditetit në rrethana normale dhe gjithashtu nën testet e stresit. Rezultatet diskutohen në Komitetin e Menaxhimit të Riskut të Likuiditetit.

Për më tepër, Banka ka gjithashtu një plan të paparashikueshëm të likuiditetit i cili mundëson menaxhimin efektiv të likuiditetit në rast të rrethanave të papritura.

Banka për Biznes Sh.a.**Shënimet e pasqyrave financiare**

Për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017

*(Shumat janë në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)***26. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR (VAZHDIM)****d) Risku i likuiditetit (vazhdim)****Menaxhimi i riskut të likuiditetit**

Banka mat riskun e likuiditetit duke përdorur analizën e hendekut të likuiditetit i cili paraqet maturitetet e mbetura të pasurive dhe detyrimeve financiare. Maturiteti i mbetur është periudha midis datës së detyrimit kontraktual të pasurisë / detyrimit dhe datës së bilancit. Tabelat në vijim tregojnë rrjedhat e parave të paskontuara të detyrimeve financiare të Bankës dhe angazhimet dhe garancitë e papërdorura të huasë në bazë të maturimit të tyre të hershëm të mundshëm kontraktual. rrjedhat e pritshme të parave të Bankës të këtyre instrumenteve ndryshojnë shumë nga kjo analizë. Për shembull, llogaritë e kërkesave pritë të mbajnë balanca të rritura ose të qëndrueshme.

31 dhjetor 2017	Deri në 1 Muaj	1 -3 Muaj	3 - 6 Muaj	6 - 12 Muaj	Mbi 12 Muaj	Gjithsej
Pasuritë financiare						
Paratë e gatshme dhe në banka	17,833	-	-	-	-	17,833
Gjendja me BQK	33,998	-	-	-	-	33,998
Kreditë dhe paradhëniet për banka	-	-	-	1,450	-	1,450
Letrat më vlerë të mbajtura për shitje	50	-	340	4,983	11,779	17,152
Kreditë dhe paradhëniet për klientë	5,358	6,459	13,039	24,572	81,886	131,314
Pasuritë tjera financiare	143	-	-	-	-	143
Gjithsej	57,382	6,459	13,379	31,005	93,665	201,890
Detyrimet financiare						
Depozitat e klientëve	90,315	4,628	9,110	50,122	23,605	177,780
Borxhet e varura	-	-	-	40	800	840
Huamarrjet	-	1,114	-	1,114	1,915	4,143
Detyrimet tjera	1,673	-	-	-	-	1,673
Garancionet e lëshuara	1,275	-	-	-	-	1,304
Zotimet për kredi të pashfrytëzuara	5,899	-	-	-	-	5,899
Gjithsej	99,162	5,742	9,110	51,276	26,320	191,610
Hendeku i likuiditetit	(42,809)	717	4,269	(20,271)	67,345	10,280

31 dhjetor 2016	Deri 1 Muaj	1-3 Muaj	3-6 Muaj	6-12 Muaj	Mbi 12 Muaj	Gjithsej
Pasuritë financiare						
Paratë e gatshme dhe në banka	12,691	-	-	-	-	12,691
Gjendja me BQK	27,248	-	-	-	-	27,248
Kreditë dhe paradhëniet për banka	-	350	-	200	50	600
Letrat më vlerë të mbajtura për shitje	-	70	3,799	7,016	7,382	18,267
Kreditë dhe paradhëniet për klientë	4,282	6,586	8,645	17,400	64,972	101,885
Pasuritë tjera financiare	237	-	-	-	-	237
Gjithsej	44,458	7,006	12,444	24,616	72,404	160,928
Detyrimet financiare						
Depozitat e klientëve	76,585	3,424	10,512	37,520	12,557	140,598
Kreditë e varura	-	4	41	-	1,800	1,845
Huamarrjet	-	45	48	800	3,355	4,248
Detyrimet tjera	1,346	-	-	-	-	1,346
Garancionet e lëshuara	2,168	-	-	-	-	2,168
Zotimet për kredi të pashfrytëzuara	5,615	-	-	-	-	5,615
Gjithsej	85,714	3,473	10,601	38,320	17,712	155,820
Hendeku i likuiditetit	(41,256)	3,533	1,843	(13,704)	54,692	5,108

Banka për Biznes Sh.a.

Shënimet e pasqyrave financiare

Për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017

(Shumat janë në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

26. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

e) Risku operacional

Në përputhje me rregulloren e BQK-së, risku operacional përcaktohet si risku i humbjes që del nga proceset e papërshtatshme ose të dështuara të brendshme, njerëzit, sistemet ose ngjarjet e jashtme. Ky përkufizim përfshin riskun ligjor, por përjashton riskun strategjik dhe riskun reputacional. Për të siguruar një menaxhim efektiv të riskut operacional, banka ka implementuar një kornizë të riskut operacional i cili përfshin politikat dhe procedurat, teknikat dhe mjetet për identifikimin, vlerësimin, parandalimin/kontrollimin dhe monitorimin e riskut operacional.

Për të përmirësuar dhe rritur efektivitetin e kontroleve të brendshme në proceset e bankës dhe për të regjistruar të gjitha humbjet e riskut operacional, banka ka krijuar një "bazë të dhënash për ngjarjet e humbjes" ku regjistrohen të gjitha ngjarjet që shkaktojnë humbje operationale ose rreziqe potenciale që mund të shkaktojnë humbje. Kufijtë dhe linjat e raportimit të këtyre humbjeve përcaktohen në politikat e menaxhimit të riskut operacional. Për më tepër, procedura e riskut operacional përshkruan në detaje hapat që banka ndërmerr nga informacioni i mbledhur në bazën e të dhënave të ngjarjeve të riskut operacional.

Kjo bazë e të dhënave konsiderohet të jetë burimi më i mirë i informacionit për zhvillimin e modeleve për matjen e ekspozimit të bankës ndaj riskut operacional pasi ofron informata për shkaqet e humbjes. Për më tepër, nëpërmjet informacionit të mbledhur nga kjo bazë e të dhënave janë vendosur masa korrektuese ose parandaluese për të parandaluar / kontrolluar këtë risk.

Vlerësimi vjetor për proceset e ndryshme në bankë është pjesë e kornizës së menaxhimit të riskut operacional të bankës. Nëpërmjet këtij vlerësimi banka mbledh informacion të dobishëm për përcaktimin e profilit të riskut operacional të bankës dhe vlerëson rreziqet që banka i'u është ekspozuar, duke përfshirë shkallën e implementimit të kontrollit. Kjo mundëson përmirësimin e proceseve të kontrollit përmes masave të ndryshme, duke reduktuar kështu ndikimin e humbjeve nga risku operacional.

Menaxhimi efektiv i riskut operacional nënkupton njohjen e pozicionit të bankës dhe profilit të riskut. Prandaj, për këtë qëllim, banka përdor treguesit kryesor të riskut (KRIs) për të monitoruar drejtuesit e ekspozimeve të lidhura me rreziqet kryesore. Këta tregues monitorohen në baza të rregullta (muajore/tremujore) në mënyrë që të lehtësojnë menaxhimin e riskut operacional duke ofruar sinjale paralajmëruese të hershme për ndryshimet që mund të tregojnë shqetësime risku.

Në krijimin e një menaxhimi efektiv të riskut operacional, banka ka ndërmarrë aktivitete të ndryshme në lidhje me rritjen e ndërgjegjësimit të riskut kryesisht përmes trajnimeve, të cilat ofrohen për të gjithë stafin e bankës në baza vjetore. Këto trajnime synojnë të rrisin njohuritë lidhur me menaxhimin e riskut operacional përmes diskutimit të skenarëve të ndryshëm në ngjarjet e mëparshme të riskut operacional. Për më tepër, trajnimet adresojnë kanalet përmes të cilave duhet të monitorohen dhe raportohen ngjarjet e riskut operacional.

Përveç kësaj, banka ka zbatuar një proces për të siguruar që ndryshimet në produktet, shërbimet ose proceset (ekzistuese ose të reja) të kalojnë shqyrtimin dhe miratimin e riskut. Kjo do të sigurojë që risku operacional që vjen nga proceset, produktet ose shërbimet e reja në bankë të monitorohet dhe të trajtohet menjëherë.

Banka llogarit pagesën e kapitalit për riskun operacional duke përdorur Metodën e Treguesit Bazë (BIA) siç përcaktohet nga rregullorja e Bankës Qendrore mbi Menaxhimin e Riskut Operacional.

Banka për Biznes Sh.a.

Shënimet e pasqyrave financiare

Për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017

(Shumat janë në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

26. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

f) Menaxhimi i riskut të kapitalit

Banka e menaxhon kapitalin e vetë për të siguruar që Banka do të jetë në gjendje të vazhdojë sipas principit të vazhdueshmërisë përderisa maksimizon kthimin tek aksionarët përmes përmirësimit të borxhit dhe bilancit të kapitalit. Strategjia e përgjithshme e bankës mbetet e pandryshuar që nga viti 2015.

Struktura e kapitalit të bankës përbëhet nga kapitali i paguar, rezerva për riskun e përgjithshëm dhe fitimet e mbajtura. Politika e Bankës është të mbajë një bazë të fortë kapitali në mënyrë që të ruajë besimin e investitorëve, kreditorëve dhe të tregut dhe për të mbështetur zhvillimin e ardhshëm të biznesit. Ndikimi i nivelit të kapitalit në kthimin e aksionarëve është njohur gjithashtu dhe Banka njeh nevojën për të mbajtur një ekuilibër midis kthimeve të larta që mund të jenë të mundshme me kthim më të madh dhe avantazhet dhe sigurinë që ofron një pozicioni i fortë i kapitalit.

Kapitali rregullator

Banka monitoron adekuatshërinë e kapitalit, me theks të veçantë rregullat dhe indikatorët e lëshuar nga Banka Qendrore e Kosovës ("BQK"). Raporti i adekuatshërisë së kapitalit është raporti i kapitalit rregullativ me pasuritë e ponderuara me risk, zërat jashtëbilancore dhe rreziqet tjera i shprehur në përqindje. Minimumi i kërkuar për raportin e adekuatshërisë së kapitalit është 8% për kapitalin e klasit të parë dhe 12% për gjithsej kapitalin.

Pasuritë e peshuara me risk (MPRR)

Pasuritë peshohen sipas kategorive të gjëra të riskut kombëtar, duke ia mveshur peshën e riskut sipas shumës së kapitalit që do të nevojitet për ti mbështetur ato. Gjashtë kategori të peshimit të riskut (0%, 20%, 50%, 75%, 100%, 150%) aplikohen; Për shembull paraja e gatshme dhe instrumentet e tregut të parave peshohen me zero risk, që nënkupton që nuk nevojitet kapital shtesë për ti mbajtur këto pasuri. Pasuria dhe pajisjet peshohen me 100% risk duke nënkuptuar se duhet patjetër të mbështeten me Kapital (Klasit të parë) baraz me 8% të vlerës kontabël. Zotimet kreditore të zërave jashtëbilancor janë marrë në konsideratë. Shumat pastaj janë peshuar me risk me përqindjen e njëjtë sikurse për pasuritë bilancore.

	2017	2016
Gjithsej pasuritë e peshuara me risk	126,575	99,926
Gjithsej ekspozimet jashtëbilancore të peshuara me risk	713	1,398
Gjithsej pasuritë e peshuara me risk për riskun operacional	12,747	10,545
Gjithsej	140,035	111,869
Kapitali rregullativ (Gjithsej Kapitali)	21,617	16,526
Indikatori i Adekuatshërisë së Kapitalit (Gjithsej Kapitali)	15.44%	14.77%

Banka për Biznes Sh.a.**Shënimet e pasqyrave financiare**

Për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017

*(Shumat janë në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)***27. TRANSAKSIONET ME PALËT E NDËRLIDHURA**

Palët konsiderohen si të lidhura në qoftë se njëra prej tyre ka aftësinë për të kontrolluar tjetrën apo të ushtrojë një influencë të rëndësishme mbi atë në marrjen e vendimeve financiare dhe operative. Palët kontrolluese me automatizëm konsiderohen aksionaret e listuar në notën 24 kapitali i aksionareve dhe rezervat. Kur konsiderohet çdo marrëdhënie ndërmjet palëve, vëmendje i kushtohet përmbajtjes së marrëdhënies dhe jo thjesht formës ligjore.

Një përmbledhje e bilanceve të palëve të ndërlidhura, në fund të vitit janë si në vijim:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Pasuritë:		
<i>Kreditë aktive në fund të vitit tek aksionarët dhe menaxhmenti kryesor</i>	Vlerësimi i BQK *	Vlerësimi i BQK *
Enrad-Ex Newco Jugo Term	A 1,542	A 1,553
Eng Office	A 501	A 613
Ismet Sylejmani (Vatani Sh.p.k.)	A 100	A 95
Uniprojekt	A 113	A 187
Naser Aliu – Uniprojekt	A 17	A 12
Besnik Vrella – Uniprojekt	A 9	A 13
Agim Bilalli – Uniprojekt	A 12	A 3
Sokol Krasniqi	A -	A 3
Brymako	A 12	A 21
Ahmet Arifi	A 1	A 16
Naim Abazi (Medianam shpk)	A 205	B 167
Aksionarët tjerë dhe menaxhmenti	A 110	A 98
Gjithsej	2,622	2,781
Garancionet dhe letrat e kreditit me aksionar	A 11	A 40
Kreditë dhe paradhënie të Banka Di Cividale	-	-

*) A: Kategoria Standard kategori B: Kategoria në vëzhgim C: Kategoria nën standardë

Kreditë për palët e ndërlidhura jepen në terma komerciale.

	2017	2016
Kreditë të aksionarët, bruto	2,512	2,683
Lejime për zhvlerësim	(4)	(12)
Gjithsej kreditë të aksionarët, neto	2,508	2,671
Kolaterali në kesh	(2,026)	(2,525)
Kreditë të aksionaret, neto	482	146
	2017	2016
Kreditë bruto të menaxhmenti dhe anëtarët e bordit	110	98
Kreditë të menaxhmentin neto	110	98
Kolaterali në kesh	(48)	(69)
Neto ekspozimi të menaxhmenti	62	29

Banka për Biznes Sh.a.**Shënimet e pasqyrave financiare**

Për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017

*(Shumat janë në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)***27. TRANSAKSIONET ME PALËT E NDËRLIDHURA (VAZHDIM)**

	2017	2016
Detyrimet:		
<i>Llogaritë bankare me aksionar</i>		
Caffe group n.t.sh	26	29
Mejdi Rexhepi	307	227
Enrad	3	-
Rrustem Aliaj	72	20
Malësia Reisen	42	44
Frutex sh.p.k	202	40
Shaqir Palushi	132	3
Naser Aliu - Uniprojekt	4	-
Besnik Vrella- Uniprojekt	5	15
Ahmet Arifi	1	-
Vatani Sh.p.k	1	1
Moneta sh.p.k	1	227
Nazmi Viça	20	-
Sokol Krasniqi	2	3
Medianam Sh.p.k	37	1
ENG Office	8	-
Aksionarët tjerë dhe menaxhmenti	157	62
Gjithsej	1,020	672
Huazimi nga BERZH	1,000	2,000
Gjithsej detyrimet	2,020	2,672

Më poshtë janë transaksionet me palët e ndërlidhura gjatë vitit.

	2017	2016
Të ardhurat:		
Të ardhurat nga interesi	56	117
Gjithsej të ardhurat:	56	117
Shpenzimet:		
Shpenzimet e interesit nga huazimet prej BERZH	69	112
Kompensimi i menaxhmentit kryesor	350	342
Kompensimi i bordit të drejtorëve	42	38
Gjithsej shpenzimet	461	492

28. NGJARJET PASUESE

Nuk ka ngjarje të rëndësishme pas datës së raportimit që mund të kërkojë rregullim ose dhënie informacionesh shpjeguese në pasqyrat financiare.